



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, MBAJTUR MË 23.8.2011

TRANSKRIPT

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 23.8.2011.GOD.

GUSHT – AVGUST
2011

E martë, më 23.8.2011,

Drejton seancën kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra të Kabinetit Qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e, ta quajmë të sesionit vjeshtor, edhe pse pak më herët se sa që është e planifikuar me Kushtetutë, pas një pushimi të shkurtër, shpresoj se keni marrë energji të reja për t'ia filluar punës.

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në mbledhje janë të pranishëm 75 deputetë, andaj fillojmë me punimet e mbledhjes plenare, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit.

Para se të fillojmë me pikën e rendit të ditës, që është koha për deklaratimet jashtë rendit të ditës, fjalën e ka kërkuar kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi dhe ia jap fjalën.

KRYEMINISTRI: Faleminderit!
I nderuar kryetar Krasniqi,
Kabinet Qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,

Pasi që kemi pasur një periudhë të shkurtër kohore të pauzës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, më lejoni që, por edhe kanë ndodhur gjëra të rëndësishme në këtë periudhë. Gjithashtu për hir të transparencës dhe përgjegjësisë shtetërore që kemi para institucioneve, Kuvendit dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, më lejoni që t'ju informoj juve dhe të gjithë qytetarët lidhur me zhvillimet e fundit në veriun e Kosovës dhe të bëj një përmbledhje kronologjike të ngjarjeve, që nga 25 korriku, 20 korriku, kur Qeveria e Republikës së Kosovës autorizoi vendimet dhe veprimet e nevojshme për zbatimin e masave reciproke tregtare të vendosura nga shteti i Kosovës, kundër Serbisë. Pra, të nderuar deputetë, Qeveria e Republikës së Kosovës, më 20 korrik mori vendim për aplikimin e masave të reciprocitetit për mallra që janë importuar nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina.

Natyrisht, ky vendim ka filluar të zbatohet në të gjitha pikat kufitare menjëherë, me përjashtim të pikës 1 dhe 31 në veri të vendit, ku policët kufitarë të nacionalitetit serbë së bashku me policët e EULEX-it, kanë refuzuar të zbatojnë vendimin për ndalimin e mallrave që vijnë nga Serbia.

Siç edhe jeni në dijeni si rrjedhojë me 25 korrik, unë si kryeministër, në bazë të autoritetit tim kushtetues, kam autorizuar Policinë e Kosovës, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e

nevojshme për vendosjen e sundimit të ligjit, dhe zbatimin e vendimit për reciprocitet në pikën 1 dhe 31.

Pas përfundimit të operacionit të njërive speciale të Policisë së Kosovës në veri të vendit u krijuan kushtet që policia e rregullt kufitare dhe doganierët e Republikës së Kosovës të vendosen në pikën 1 dhe 31. Fatkeqësisht, më 27 korrik, një grup i organizuar kriminal, i udhëhequr nga liderë të strukturave kriminale serbe dhe të motivuara nga autoritetet e Beogradit, kanë sulmuar fillimisht pikën 1 dhe më pas atë 31.

Fatkeqësisht, këto veprime të dhunshme janë urdhëruar, koordinuar dhe udhëhequr nga strukturat më të larta politike të qeverisë së Serbisë, për çka shteti i Kosovës, Beogradin e bën përgjegjës drejtpërdrejt edhe për dhunën, djegien e pikës kufitare dhe vrasjen e policit **Enver Zymberi**.

Djedia e pikës 1 është bërë prej njerëzve me maska, por gjithçka ishte e qartë. Pas kësaj djegie qëndron politika e shekullit të kaluar, të cilën Serbia ende vazhdon të zbatojë në raport me Kosovën. Kjo politikë e njëjtë po vazhdon edhe sot për të mbështjellur me një kamuflazh fals të demokracisë, mirëpo askush në botë nuk u beson trillimeve dhe gënjeshtreve të Serbisë zyrtare, prapa të cilave fshihet dëshira e sëmurë për uzurpim të një pjese të territorit tonë. E kemi theksuar, zotohemi këmbëngultësisht se as de facto as de jure nuk do të ketë ndarje të Kosovës. Vendimi i 25 korrikut, e kam theksuar edhe më herët, ka qenë jo i lehtë por ka qenë i drejtë, legal dhe legjitim. Ka qenë vendim për veprim të domosdoshëm, ka qenë vendim që ka demonstruar edhe një herë se Qeveria është e përcaktuar të vendosë rendin dhe ligjin në tërë territorin e Republikës së Kosovës, demonstrim i qartë i përcaktimit tonë për luftimin e krimit dhe korrupsionit në çdo cep të territorit të Republikës së Kosovës. Në lidhje me këtë vendim dhe veprim kemi pasur bashkëpunim dhe konsultim të vazhdueshëm me faktorët relevantë ndërkombëtarë deri në atë nivel që është konsideruar i mjaftueshëm për të zbatuar suksesshëm operacionin. Eulex ka qenë i informuar vazhdimisht për gjendjen e patolerueshme në veri tash e tri vjet e gjysmë. Të gjithë faktorët ndërkombëtarë kanë qenë të informuar tash e dymbëdhjetë vjet e gjysmë, për gjendjen e patolerueshme në veri. Eulex ka hezituuar të jetë mbështetës i vendimit të institucioneve të Republikës së Kosovës për vënien e rendit dhe ligjit. Por, pas vendimit dhe veprimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Eulex është deklaruar se dëshiron dhe është i gatshëm të punojë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës duke e dëshmuar bashkëpunimin në veprime të përbashkëta të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Eulexit. Ne kemi pasur dhe vazhdojmë të kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me KFOR-in, për çka falënderoj gjithë stafin komandues në krye me gjeneralin **Bühler**. Ju jeni të informuar, të nderuar deputetë, për marrëveshjen e përkohshme, të cilën KFOR-i dhe Qeveria e Kosovës e ka bërë për deblokimin e rrugëve, për mbajtjen e situatës nën kontroll nga ana e trupave të KFOR-it. Qeveria e Republikës së Kosovës e mbështet edhe sot këtë marrëveshje me qëllim që të normalizohet gjendja atje dhe të zhblokohen rrugët. Fatkeqësisht marrëveshja në mes Qeverisë së Kosovës dhe KFOR-it nuk është respektuar në tërësi dhe ka barrikada që nuk janë hequr nga rrugët. Ne vazhdojmë të kemi besim në autoritetin e KFOR-it për përmbushjen e zotimeve që dalin nga kjo marrëveshje, mirëpo dua të theksoj se ne do të vazhdojmë përkushtimin tonë deri në fund për rend dhe ligj. Tashmë, Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare kanë qëndrime unike për veriun e vendit pas 12 vjet e gjysmë, që do të thotë se nuk do të ketë kthim në gjendjen e para 25 korrikut. Kjo është konfirmuar tanimë edhe nga Brukseli, edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës,

nëpërmes zyrtarëve të lartë që vizituan Republikën e Kosovës, javëve të fundit. Vendimi për të futur në kontroll vendkalimet kufitare në veri të vendit, edhe pse ka qenë i vonuar, ai ka qenë i domosdoshëm, shumë i drejtë, legal dhe legjitim, ka qenë i modelit evropian. Ne nuk mund të jemi indiferent dhe përjetësisht të tolerojmë që një pjesë e territorit tonë të jetë vrimë e zezë jo vetëm e Kosovës, por edhe e Evropës. Ne nuk mund të toleronim që përjetësisht që sovraniteti ynë të cenohej. Nuk mund të lejojmë që një pjesë e atdheut tonë të përdoret, të shfrytëzohet si vendkalim për mallra të kontrabanduara. Nuk mund të lejonim që përjetësisht të cenohej sovraniteti ynë, sepse kjo ishte në kundërshtim jo vetëm me parimet e ligjeve dhe Kushtetutës tonë, por në kundërshtim të plotë edhe me vlerat dhe parimet evropiane. Ne jemi munduar që përmes dialogut me Serbinë të zgjidhim shumë probleme praktike, që kemi zgjidhur edhe me vendet tjera të rajonit. Përderisa ne do të vazhdojmë dialogun për çështje praktike si shtet i Kosovës me Serbinë, kjo assesi nuk nënkupton që Serbisë, do t'i jepet e drejta e vetos, për vendosjen e rendit dhe ligjit në Kosovë. Republika e Kosovës në dialog me Serbinë janë palë të barabarta dhe bisedojnë si dy shtete të pavarura, rrugët e të cilëve shpijnë në integrimin edhe në NATO edhe në Bashkimin Evropian. Pra, të nderuar deputetë, nga 25 korriku, Kosova është ndryshe. Është hapur një kapitull i ri i sovranitetit të plotë të Republikës së Kosovës dhe më lejoni të përsëris edhe një herë se në asnjë rrethanë nuk do të ketë kthim prapa, përkundrazi duhet të punojmë të gjithë për të konsoliduar gjendjen. Kjo është faza e parë, të nderuar deputetë, e implementimit të vendimit për vënien e rendit dhe ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës dhe organet që janë përgjegjëse për rend dhe ligj, do të jenë të pa kompromis dhe me çdo çmim do të sjellin para drejtësisë përgjegjësit për vrasjen e policit dhe heroit të Kosovës **Enver Zymberaj**, do të sjellim para drejtësisë të gjithë paramilitarët dhe kriminelët që djegin pikat kufitare të Kosovës dhe që dhunojnë rendin Kushtetues të Republikës së Kosovës. Krimi i organizuar në veri, strukturat kriminale në veri, nuk janë rrezik lokal, janë rrezik për rajonin dhe do të jemi të pa kompromis kundër tyre. Do t'i sjellim para drejtësisë të gjithë kontrabandistët, strukturat kriminale dhe të gjithë kriminelët, të cilët për 12 vjet me radhë kanë bërë krime duke menduar se janë të paprekshëm dhe duke konsideruar se veriu i Kosovës do të mbetet përgjithmonë parajsë e sunduar nga kriminelët. Tanimë ai kapitull ka përfunduar një herë e përgjithmonë, më 25 korrik.

Unë për vrasësit, strukturat kriminale në veri, kriminelët dhe kontrabandistët, kam sot nga Parlamenti i Kosovës një mesazh të qartë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, punon këmbëngultësisht që të integrojë gjithë komunitetin serbë në jetën e re demokratike, në një proces elektoral demokratik, ku qytetarët atje do të kenë mundësi përfaqësuesit e vet në institucione lokale dhe qendrore, që të krijohen kushtet dhe mundësitë më të mira për të investuar, ndërsa falënderoj që gjithnjë e më tepër ka distancim prej këtyre strukturave kriminale të shumicës së qytetarëve në veri.

Pra, qytetarët serbë në veri janë peng dhe viktimë e krimit të organizuar, që udhëhiqet e dirigjohet drejtpërdrejt nga politika e Beogradit. Pra, mesazhi im për këto struktura kriminale është dita se kur do të ulen në karrigen e të akuzuarve për vrasje dhe krime të rënda nuk është larg, dhe se fitorja e së mirës, rendit dhe ligjit kundër të keqes, krimit do të jetë e afërt. Kjo është ajo çfarë presin qytetarët e Republikës së Kosovës, çfarë presin miqtë dhe partnerët tanë ndërkombëtarë, çfarë pret misioni i rendit dhe ligjit në Kosovë, kjo është ajo çfarë duhej të bëhej në shtetin e Kosovës, ky është vullneti i qytetarëve të

vendit, ky është obligimi ynë kushtetues dhe ligjor, prandaj unë dëshiroj edhe një herë të theksoj se Qeverisa e Republikës së Kosovës do të vazhdojë me agjendën e vet të planifikuar me autoritetin e vet kushtetues dhe ligjor, me modelet e veta angazhuese evropiane. Prandaj, në këtë rrugë për rend dhe ligj nuk ka qasje tjetër. Beteja kundër së keqes në veri, kundër strukturave kriminale, nuk është betejë politike është për rend dhe ligj. Prandaj, të nderuar deputetë, tani mund të them lirisht se kemi në pikën 1 dhe 31 të instaluar KFOR-in, ndërsa me krijimin e kushteve për punë do të instalohen edhe doganierët dhe policët kufitarë të Republikës së Kosovës. Tani për tani qarkullimi komercial, ju e dini që është i ndaluar plotësisht, është i bllokuar plotësisht. Janë duke u penguar edhe në rrugët alternative mundësitë e kontrabandës. Gjithashtu, tani kontrollohet për herë të parë edhe treni që qarkullon nga Beogradi në drejtim të Mitrovicës. Pra, kemi kontroll të plotë në kuptimin e sovranitetit të Kosovës dhe ajo që do të duhej të ndodhte në qershor të vitit 1999, të instalohet KFOR-i në pikat kufitare dhe në kufi, mes të shtetit të Kosovës dhe Serbisë, ka ndodhur tani. Gjithashtu, kontrabanda është ndaluar për herë të parë. Do të vazhdojmë këmbëngultësisht edhe në të gjitha pikat alternative klandestine, që po përpiqen që kjo të ndalet maksimalisht.

Gjithashtu dëshiroj të theksoj për një bashkëpunim shumë të mirë në mes të KFOR-it dhe Policisë së Kosovës. Pra, të nderuar deputetë, qytetarë të Kosovës, më lejoni edhe një herë që si kryeministër, të shprehë mirënjohjen time të thellë për mbështetjen me rezolutë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që i ka dhënë veprime të ligjshme të Qeverisë për sundimin e rendit dhe ligjit në veri të vendit. Më lejoni të shpreh konsideratën time të lartë për të gjitha partitë politike që kanë dëshiruar të jenë pjesë e procesit mbështetës. Falënderoj liderët dhe zyrtarët e tyre që kanë komunikuar drejtpërdrejt edhe me mua edhe në rastin e arritjes së marrëveshjes me KFOR-in, në mënyre që kanë mbështetur në mënyrë korrekte dhe konstruktive përcaktimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

Mbi të gjitha, më lejoni të shpreh mirënjohjen time të lartë për maturinë që kanë treguar qytetarët e Republikës së Kosovës të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Kosova është atdheu ynë dhe do të jetojmë bashkërisht të gjithë në ambient demokratik. Falënderoj qytetarët për maturinë dhe përmbytjen e tyre. Ata, përveç që kanë demonstruar se i besojnë plotësisht institucioneve të Republikës së Kosovës, ata kanë dëshmuar se nuk i përkrahin dhe nuk i mbrojnë vrasësit dhe kriminelët, kontrabandistë, që bëjnë krime në kurriz të qytetarëve të vendit. Për Kosovën, të nderuar deputetë, qytetarët e Kosovës, do të ketë vetëm ecje përpara. Këtë e konfirmon edhe mbështetja, tanimë e madhe, ndërkombëtare që e kemi, por edhe njohjet e fundit, që Republika e Kosovës, ka pranuar dhe do të vazhdojë të pranojë edhe në ditët, javët dhe muajt në vijim. Dua të theksoj edhe një herë se nëse mbështetja ndërkombëtare në fillim të vendimit të 25 korrikut, nuk ka qenë shume e qartë, tani kjo mbështetje për veprimet dhe vendimet e institucioneve të Republikës së Kosovës, për rend dhe ligj në veri është mbështetje e qartë, është mbështetje unike dhe vendimet e qeverisë për rend dhe ligj në veri, e kanë përshpejtuar edhe procesin e njohjeve të Republikës së Kosovës. Pra, jemi në një proces konsolidues të shtetit të Kosovës dhe ky sukses i ri është sukseksi i të gjithëve, është sukseksi i shtetit të Kosovës. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Fillojmë me pikën-

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës.

Siç e dini, koha për këtë pikë të rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta. Dhe ju e dini që replika s'ka, andaj kërkoj nga deputetët e paraqitur për diskutim që të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Fjalën ja kisha dhënë deputetit Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit zoti kryetar,
Zoti Kryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Ministra,
Të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë,

Pas fjalës së kryeministrit, më mbetet që t'i përcjell përgëzimet dhe mbështetjen time dhe të kolegëve të mi. Njëherit edhe besimin se nuk do të ketë tërheqje, nuk do të ketë dilema, nuk do të ketë asnjë ekuivok në vendimet e Qeverisë dhe në veprimet e saj. Unë, si për vendorët, ashtu edhe për ndërkombëtarët, do të sjell nga 3 libra këtu, të botuara në Serbi, në vitet 1902-1903 dhe të ribotuara, njëra prej tyre, më 1997, nga autorë eminentë të njohur edhe të cilët do të duhej të shërbejnë për çdo vendim dhe për çdo observim në lidhje me problematikat në terren, konkretisht në Kosovë.

Unë do të filloj telegrafikisht, shumë shpejtë, me librin "Atdheu", udhëpërshkrim është, 1880 – 81, që e ka titulluar "Atdheu" Mita Rakiq, botues një shtypshkronjë e Novi Sadit dhe e ribotuar, po ashtu, më 1997, që për habinë time nuk ka pasur reagime, fillon:

Në faqen 16, shkurtimisht do të mundohem: "Kurshumlija ka qenë qendra e arrnautëve në këtë vend, kanë jetuar dhe kanë sunduar arrnautët e pastër". Këtu në Kurshumli, thotë, kanë qenë më të ashprit dhe, thënë me të drejtë, më sovranët. Në faqen 17, paragrafi pasues- „Të gjithë udhëpërshkruesit, ndër ta edhe studiuesi me origjinë gjermane, flet autori, Hani, ka qenë ndër mikëpritësit e këtij vendi, por, që ka treguar se kanë qenë shumë të mirëpritur ndaj mikëpritësve, por të ashpër. Kjo është kopertina e librit, që ta shoh edhe publiku, sepse nuk e kam sajuar unë dhe është në çirilicë, dhe është ribotuar, po në Serbi. E botuar më 1901, udhëpërshkrim i Mita Rakiqit, 1880 – 1881.

Tani do të shfletoj shumë shpejtë edhe librin tjetër me një citim.

Është në dy pjesë. Botues „Ama Serbe“, më 1909 Novi Sad Titulli „Kosova-udhëpërshkrimi i tokave dhe i popujve“ i Branislav Nushiçit.....

KRYETARI: Kur e ke lyp kohën në emër të grupit i ke 5 minuta, vazhdo në emër të grupit deri në.... (dëgjohen zëra)... po kërko lajmërohu në fillim.

HALIT KRASNIQI: ... është faqe ...Libri është ky që ta shoh edhe publiku, është po ashtu në çirilicë. Edhe kemi fakte jashtëzakonisht të forta shkencore dhe këtu kemi 2 foto, që unë do të shoh shqiptarët me plisa të bardhë këtu rreth e rreth Graçanicës, manastirit dhe duke hedhur valle këtu... që e kanë konsideruar si objekt të tyre këtu. Dhe kemi objektin tjetër në Patriarkanë të Pejës, këtu. Një valle rugove këtu rreth e rreth objektit, e botuar në çirilicë edhe kjo. Është botuar në Novi Sad në 1903-tën. Tani unë do të vazhdojë edhe me

një tekst tjetër ku do të kemi një fotografi rrëqethëse nga burgu i Prishtinës, dhe që autori e ka publikuar për t'i qetësuar publikun e atëhershëm dhe për t'i treguar se pushteti serb nuk është mikpritës, se është mjaft i ashpër me shqiptarët dhe në këtë libër ka sjellë një fotografi ku tregon 2 katet me shqiptarë të burgosur. Është në çirilicë po kjo. Është botim origjinal i "Amës Serbe" në Novi Sad, dhe janë dy katet me shqiptarë me plisa të bardhë këtu, dhe natyrisht që shkruan "hapsane i hapsanici u Pristini". Unë për veten time nuk i kam sajuar këtu dhe nuk ka pas botues ndër shqiptar që t'i kenë botuar për fakte historike këto, por që tani duhet të na shërbejnë edhe për vendorët tanë edhe për ndërkombëtarët në çdo vendimmarrje. Unë ju falënderoj!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Arben Gashi, vetëm le të lajmërohet a është në emër të grupit apo në emër të vet.

ARBEN GASHI: Faleminderit i nderuar Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë flas në emër timin, nuk flas në emër të grupit në këtë rast. Më dalin 3 minuta boll për të tregu vazhdimin negativ të kësaj qeverisjeje, dhe qasjen në një segment. Sot do të flas për një segment pak më specifik, sa përket marrëdhënieve ndërkombëtare. Në qoftë se e keni pa këto ditët e fundit kemi pas disa skandale të llojit të vet, në aspektin protokollar dhe në aspektin e veprimeve dhe të papërgjegjshmërisë të kësaj qeverisjeje. Në qoftë se i shihni deklaratimet që i kanë ba zëvendëskryeministri dhe ministri i punëve të jashtme dhe konflikti që ata sjellin për meritat, që ata pretendojnë që janë merita personale, për njohje të Kosovës. Këta mundohen t'i privatizojnë këto njohje të cilat realisht janë obligim i tyre institucional dhe ligjor që t'i zbatojnë, sepse këta janë përfaqësues të shtetit të Kosovës. Si përfaqësues të shtetit të Kosovës, këta duhet të punojnë në interes të Kosovës dhe jo në interes të individëve dhe secili t'i nxjerr këshilltarët e vet apo zëdhënësit e vet dhe të tregojë se meritë e kujt është kjo njohje, sepse kjo po shkakton edhe konfliktualitet. Në qoftë se i shihni se si kanë qenë reagimet e përkrahësve ndërkombëtarë për këto njohje siç mund të jenë: Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe apo Franca e Gjermania apo Italia, të cilët janë dhe lotuesit kryesorë për njohjen e Pavarësisë së Kosovës, i bie që po na shkaktojnë edhe tensionim të raporteve me këta përkrahës të mëdhenj për Pavarësinë e Kosovës. Prandaj, unë do të kisha lut Kryeministrin që të merret vesh me ministrat e tij, që kur të ulen edhe në diskutime me palët tjera, të dinë se ku me u ulë - nga ana e vizitorit apo nga ana e mikpritësit, dhe të dinë se si duhet të deklarojë për veprimet apo raportet ndërkombëtare, të cilat ndodhin në realitetet kosovare. Në këtë kuptim duhet të kemi parasysh se zëvendëskryeministri dhe ministri janë përfaqësues legjitim të shtetit të Kosovës dhe si të tillë nuk kanë merita personale për njohjen e Kosovës. Duhet t'i koordinojnë këto njohje mes veti edhe t'i koordinojnë edhe me faktorët ndërkombëtarë të cilët e përkrahin pavarësinë e Kosovës, por jo të marrin merita personale, sepse nuk ka merita personale. Këto janë papërgjegjshmëri dhe personalizimi dhe personifikimi në një individ i këtyre njohjeve është një e keqe që po i ndodh Kosovës, dhe që realisht po i vonon njohjet e Kosovës nga shtetet tjera ku ndikimi i miqve tanë ndërkombëtarë është shumë i madh dhe ata po stepen dhe po ndalojnë siç ndodhi me rastin e një vendi shumë të madh mik, i cili ka ndiku që këto katër njohjet e fundit të jenë për Kosovën. U detyrua që zëdhënësi apo ndihmës zëdhënësi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të dalë dhe të

thotë se këto janë edhe merita të Qeverisë se caktuar dhe jo merita individuale të ndonjë zëvendëskryeministri apo ministri. Prandaj, duhet të kemi parasysh se sfera e marrëdhënieve ndërkombëtare është një sferë shumë e ndjeshme. Duhet të kemi parasysh se çështjet protokollare edhe të komunikimit ndërkombëtar dhe të brendshëm janë shumë të rëndësishme dhe pjekurinë institucionale dhe profesionale. Ndoshta, Kryeministri duhet t'ua thotë ministrave dhe zëdhënësve të vet ose nëse nuk i din edhe vet, të marrë ndonjë trajnim nga ndonjë institucion.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teutë Haxhiu.

TEUTË HAXHIU: Faleminderit Kryetar,
Të nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe përkundër faktit që institucionet tona në vazhdimësi e kanë gojën plotë kur flasin për rolin dhe kontributin e diasporës sonë nëpër vite, edhe përkundër premtimeve se janë bërë të gjitha përgatitjet për pritjen e tyre sa më të mirë në vendlindjet e tyre, për fat të keq kësaj radhe në shumë raste, ndodhi e kundërta. Unë dua të pyes se përse institucionet tona shtetërore nuk ishin në nivelin e detyrës dhe përgjegjësisë së tyre ndaj kësaj kategorie vërtetë të çmuar të vendit tonë edhe këtë vit. Mendoj se sot, para së gjithash, është e tepërt të flasim këtu për rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të diasporës sonë, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, këtë e dimë të gjithë. Por, duke qenë koshient para këtij fakti, është vërtetë e papranueshme që muajt kur ata zakonisht kthehen në Kosovë, t'i gjejnë institucionet tona krejtësisht të papërgatitura për pritjen e tyre sa më dinjitoze. Nuk mjaftojnë vetëm organizimet e mbrëmjeve të ndryshme në krahasim me kryerjen e obligimeve tona ndaj tyre, sidomos obligimeve që kanë të bëjnë me rregullimin e dokumentacionit, për të cilin aq shumë kanë nevojë. Pse ata edhe sot e kësaj dite duhet që të presin me ditë dhe javë të tëra për të marrë një dokument udhëtimi. Në shumë raste zyrtarët e institucioneve tona, përgjegjës për lëshimin dhe rregullimin e dokumentacioneve nuk kanë qenë serioz gjatë punës së tyre. Si është e mundur që kur një person kërkon pasaportë t'i thuhet që atë nuk mund ta marrë para tri javësh, ndërsa nëse paguan shumë 100 euro, mund ta marrë brenda pak ditësh. Pra, sipas kësaj del se kur personi duhet të presë afatin e paraparë nuk ka pasaporta, ndërsa kur e paguan shumë e caktuar del se atëherë ka pasaporta. Mendoj se një sjellje e tillë, para së gjithash nuk i bën nder as institucioneve të Kosovës. Qytetarët tanë kanë nevojë për nxjerrjen e dokumenteve, për më tepër ata kanë nevojë për ofrim të shërbimeve cilësore për të cilat zyrtarët paguhën nga taksat e qytetarëve të Kosovës. ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Diasporës, duhet t'i sqarojnë këto mangësi në punën e zyrtarëve, që punojnë në ato sektorë dhe të kërkojnë nga ata korrektësi dhe përgjegjësi maksimale në punë. Për këtë edhe janë të thirrur. Personalisht, me përgjegjësi të plotë e them se numri i atyre që raportojnë raste të tilla nuk është i vogël. Në të vërtetë, ky fenomen nuk është vetëm gjatë kësaj vere, mirëpo dua të them se për fat të keq po vazhdon edhe sot. Gjithnjë sipas bashkatdhetarëve tanë të cilët vijnë në Kosovë, problem tjetër serioz është se pse ata janë të detyruar të paguajnë për sigurimin e automjeteve, kur ne vendet praj nga ata vijnë i kanë automjetet e siguruar. Ata janë të gatshëm pra, është propozim i tyre, që shumë më me dëshirë do të paguanin një taksë rrugore e cila ekziston edhe në vende të tjera

evropiane, dhe ato mjete të shkojnë direkt në buxhetin e shtetit, se sa të paguajnë për sigurimin e automjetit të tyre kur të njëjtin e kanë përkatësisht në dokumentet e shtetit prej nga vijnë. Shqetësim tjetër për bashkatdhetarët tanë, të cilët punojnë jashtë vendit janë rastet kur ata kërkojnë ndihmë dhe shërbime

KRYETARI: Faleminderit!

Sa i përket pasaportave, është mirë ... në të vërtetë deputetët kur ta marrin fjalën ta konsultojnë Ligjin.

Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit zoti Kryetar,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë ,

Pas fjalimit mbi situatën e krijuar në veri të Mitrovicës dhe të sinjalizimit për qetësinë, në njëfarë mënyre dhe të prezencës së rendit dhe Ligjit, unë jam i kënaqur dhe shprehi prapë gatishmërinë time personale për të përkrahur qëndrimet e Kryeministrit dhe të Qeverisë, që të vazhdohet kjo dhe të mos ketë kthim mbrapa.

Pikat të cilat unë dua sot t'i preki, janë dy pika të cilat: njëra lidhet me kompaninë "Feronikli", që është në Drenas, dhe që është një kontaminues shumë i madh i ambientit në Republikën tonë dhe qytetarëve të Drenasit, ku një komision i ... një grup i deputetëve të cilët ishim në vizitë atje kërkuam qartë angazhimet e tyre për të parë se e trajtojnë shfrytëzimin e tokës, si e kontaminojnë ujin dhe si e kontaminojnë ajrin. Fatkeqësisht, vizita e ministrit të Ambientit bërë atje ka qenë një vizitë më shumë mediatike, se sa logjike dhe shkencore dhe analitike me grup të ekspertëve, që të ketë një qasje më të mirë për ta bërë preventivën e situatës së kontaminimit që shkakton "Feronikli". Unë do të ngre pak më lartë çështjet në takimet tjera edhe në komisione parlamentare edhe po ashtu edhe në kuvend dhe kërkesën të cilën ia kemi bërë "Feroniklit", që t'i plotësojë standardet e nenit 75 të Ligjit për shfrytëzimin e minierave dhe pikën 1, 2 dhe 3. Përgjigjen të cilën e kanë kthyer ata është për t'u... është një keqinterpretim dhe një injorim total i kërkesave tona. Prandaj, këtu kërkoj nga ministri i Ambientit, që rreth "Feroniklit" të ketë një qasje, sepse atje janë një kontaminim jashtëzakonisht i lartë, është një shkaktar i sëmundjeve të mëdha të frymëmarrjes të popullatës, shkaktohet dëmtimi i ambientit dhe kontaminimi shumë i madh i ujit.

Pika e dytë është monografia e Akademisë së Shkencave për ngjarjet historike të botuar kohë më parë. Kërkoj nga Komisioni për Arsim dhe Shkencë dhe Kryesia e Kuvendit të Parlamentit të rishikohet edhe një herë dhe të vlerësohet, që t'i propozohet Kryeministrit dhe Qeverisë që ajo të tërhiqet nga tregu, sepse është një devijim total i ngjarjeve historike të ndodhura në këtë histori të re dhe në këtë 100 vjeçar....

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit i nderuar Kryetar,

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Unë sot dëshiroja ta ngris një shqetësim që kam marrë vazhdimisht gjatë gjithë këtyre dy muajve. Bëhet fjalë për bashkatdhetarët tanë, që një numër gjithmonë të kënaqshëm, janë gjatë muajve të verës këtu në Kosovë. Dhe, ata edhe këtë vit i ka pritë ajo befasia jo e këndshme, që në kufi janë të detyrur të paguajnë sigurim edhe pse ata kanë sigurime nga vendet që vijnë. Unë edhe një herë kisha dëshirë që shteti të mos mjaftohet me problemet që kanë kompanitë e sigurimeve në krijimin e marrëveshjeve të përgjithshme, por të reagojë në këtë drejtim. Nëse në ndërkohë ky problem zgjidhet, nëse jo atëherë ka edhe forma tjera, që të zgjidhet kjo çështje dhe që të zvogëlohen shqetësimet e bashkatdhetarëve tanë, qoftë me një fond të veçantë dhe me pagesa shumë më formale se sa ato shuma shumë të mëdha që paguajnë ata për 1/12 e vitit që qëndrojnë një muaj në Kosovë. Prandaj, do të kisha dëshirë që të gjithë kompetentët, mendoj edhe në ministrinë adekuate për zhvillim, me që e përfshinë fushën e transportit, edhe ministria për diasporën, por edhe akterët tjerë që të merren aktivisht dhe të gjejnë problem duke mos i dëmtu bashkatdhetarët tanë, nga se të gjithë prej atyre thojnë sikur këto mjete të kishte marrë shteti, ne po i dhëmë vullnetarisht. Por, të pagujmë të gjobitemi për herë të dytë, pse nuk po zgjidhet ky problem. Është e padrejtë. Prandaj, desha të ngre këtë shqetësim dhe do të kisha lut akterët kompetentë, që të merret intenzivisht me këtë çështje, dhe në momentin kur krijohet ideja se po mund të zgjidhet ky problem dhe forma ta bëjmë publike, në mënyrë që bashkatdhetarët tanë të jenë në dijeni për përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës në lidhje me këtë shqetësim të tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju kisha lut deputetëve, që edhe një herë po them, të konsultohen me ligjet për çështjet që i ngritin. Duhet të ndryshohen ligjet për t'u realizuar ajo që e tha edhe deputeti tani edhe deputetja më parë. Ligjet duhet të ndryshohen, se ligjet janë ato që janë dhe administrata është e obligueshme t'i respektojë ligjet që janë në fuqi. Po më duket fjalën e ka... (dëgjohen zëra) .. ligjet ndryshohen deputet, duhet ta diësh që ligji duhet të ndryshohet pastaj të veprojë administrata sipas ligjit. Kjo është obligim i yni dhe kjo duhet të jetë kërkesë e jona. Ndryshimi i ligjeve nëse ligjet janë bërë pengesë për një çështje. Këtu duhet të sundon rendi dhe Ligji dhe ne duhet të bëjmë ligje, duhet të ndryshojmë ligje, kur ato bëhen pengesë për një zhvillim. Fjalën e ka deputeti Sali Asllani.

SALI ASLLANI: Faleminderit Kryetar,
Përsëritje për kabinetin Qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Unë desha me e ngritë një çështje, e cila është bërë temë shumë aktuale e bisedave në çdo tavolinë, në çdo vend. Ishte vizita e fundit e ministrit të Arsimit të Turqisë në Kosovë dhe kërkesa e tij për rishkrimin e historisë së Kosovës, në raport me perandorinë osmane. Unë mendoj se ka qenë një kërkesë shumë prepotente dhe ka qenë shumë e pajustificueshme dhe mendoj se pozicioni i ministrit tonë të arsimit ka qenë inferior, gjë që kisha kërku që secili në Kosovë ta ketë një vijë të kuqe, ku s'do të duhej t'i lejonte askujt ta kalojë atë vijë të kuqe. Mendoj se historiografia jonë është çështje e historianëve tanë, të cilët nuk pretendoj që nuk ka gabime, ndoshta, edhe në shkrimet e tyre, por realisht ajo duhet me

ardhë si fryt i një vlerësimi tonë të brendshëm për rishkrim të historisë së përgjithshme, sepse dihet që shumica e historisë është shkruar në kohën e një sistemi komunist, por jo si fryt i presioneve ndërkombëtare, pa marrë parasysh miqësinë, momentin aktual politik dhe mirënjohjen e thellë që kemi për Turqinë, në aspektin e përkrahjes së Kosovës. Zoti ministër kisha pasur dëshirë me të pa në nivel pak më të lartë dhe me tregu ministrit të arsimit me i thënë në formë shumë të qartë, që çështja e rishkrimit të historisë është çështje vetëm e jona dhe e askujt tjetër nga jashtë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit,

Nuk kemi për këtë pyetje të interesuar... jo, më vonë mbasi ta kryejmë këtë pikë mund ta kërkojsh fjalën. Do të thotë deputetët e kanë kryer fjalën e vetë. Ministri mund ta thotë, nëse ka diçka të thotë në deklarinimin e tij, ka të drejtën me nenin 48 të Rregullores së punës së Kuvendit. Fjalën e ke zoti Ministër.

Ministri RAMË BUJA: I nderuari zoti Kryetar,
I nderuari zoti Kryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Ministra,
Të nderuar deputetë,

Faleminderit zoti deputet, që ngrite këtë çështje dhe ta sqaroj për të satën herë atë që ka kërkuar ministri i Turqisë dhe atë që e kam thënë unë në deklarinimet publike, për të cilat nuk kam çka të shtoj. As ai nuk ka kërkuar që të ndërrohet historia, e aq më pak ne mund të lejojmë që ta bëjmë një gjë të tillë, sepse s'ka ministër në botë, qoftë edhe i plotfuqishëm, megjithëse plotfuqishmëri s'ka, qoftë edhe profet që mund ta ndërrojë historinë se çka ka ndodhur dhe si ka ndodhur. Edhe ne nuk jemi të interesuar që ta bëjmë ndryshimin, sepse as që mund të ndryshohet. Realisht, ajo që është kërkuar, ka qenë në frymën edhe të kërkesave të Komisionit Evropian, që të hiqen nëse aty ka, eventualisht, shprehje fyese. Kaq. Nuk ka pas ndonjë gjë tjetër. Dhe, unë edhe para mediave e kam sqaruar këtë gjë. Nuk ka pas kërkesë tjetër. Çështja e qëndrimit inferior apo superior, nuk ka qenë. Aty kemi qenë kolegë homologë, jemi sqaruar për këtë gjë, dhe, po ju garantoj për një gjë, s'kam besoj, nevojë me ju garantu, që aty ku kalohet apo preket vija e kuqe, nuk lejoj as unë e as ju. Prandaj, këtu është, besoj, e panevojshme të sqarohet më shumë, për faktin se është bërë zhurmë për pak gjë. S'po e them për hiç gjë, sepse në fakt krejt çka është thënë është thënë para mediave. Nuk është thënë asgjë e veçantë brenda në takimin tonë. Prandaj, unë besoj që, kjo gjë është krejtësisht e shpjegueshme. Këto fjalë që bëhen dhe këto shkrime që bëhen unë i falënderoj, sepse mund të nxjerrin në shesh nganjëherë edhe diçka që nuk dihet, por kjo gjë për takimin tonë dhe vizitën e ministrit turk, ka pasur kaq dhe asnjë më shumë. Ju falënderoj shumë!

KRYETARI: Faleminderit, ministër.

Edhe pse çështje të tilla mund të ngritën në Rend të Ditës, pa nevojë për 3 minuta, vazhdojmë me pikën e dytë të Rendit të Ditës - Koha për pyetje parlamentare.

Në bazë të nenit 54 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashetrojnë më së shumti 2 pyetje parlamentare. Ju njoftoj se nga seanca e kaluar kanë qenë të

parashtruara 7 pyetje parlamentare. Unë do t'i thërras parashtruesit, dhe, nëse ata e konsiderojnë se të njëjtat janë ende aktuale – mund ta marrin fjalën.

Deputeti Xhevdet Neziraj – pyetje për ministrin Mahir Jagxhëllar.

Deputet e ke fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti Kryetar,

KRYETARI: Në sallë kemi 91 deputetë.

XHEVDET NEZIRAJ: I nderuar zoti Kryetar,

I nderuar zoti Kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Pyetje për ministrin e Shërbimeve Publike, zotin Jagxhëllar:

Zoti ministër, në pajtim me nenin 61 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë në përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil, në institucionet e nivelit qendror dhe lokal. Me këtë ligj përcaktohet së paku 10% e nëpunësve civil në institucionet e nivelit qendror, përfaqësohen nga stafi që i përket komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Pyetje: Sa pjesëtarë të komunitetit egjiptas janë të punësuar në nivelin qendror në këtë 10%. Për të mundësuar që sa më thjeshtë... do të thotë edhe pyetja është shumë konkrete dhe konkretisht – Sa pjesëtarë të komunitetit egjiptian janë të punësuar në këtë 10 përqindësh?

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Jagxhëllar.

Ministri i Administratës Publike, MAHIR JAGXHËLLAR:

Faleminderit i nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar ministra,

I nderuari Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Te nderuar deputetë,

I nderuari zoti Neziraj,

Në lidhje me pyetjen e juaj e cila ka të bëjë me numrin e pjesëtarëve të komunitetit egjiptas, të punësuar në nivelin qendror ju njoftoj me sa vijon:

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga institucionet e nivelit qendror, struktura etnike e të punësuarve nga komuniteti jo shumicë është rreth 8.7%, nga numri i përgjithshëm i të punësuarve. Numri i komunitetit egjiptian të punësuar në nivelin qendror është 29, apo shprehur në përqindje është 0.10%. Për më shumë Ministria e Administratës Publike në pajtim me Ligjin për shërbimin civil ka nxjerrë Rregulloren për procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në shërbimin civil të Kosovës. Në bazë të kësaj Rregulloreje duke u bazuar në Ligjin e shërbimit civil, së paku 10% e nëpunësve civil në institucionet e nivelit qendror përfaqësohen nga stafi, që i përket

komunitetit jo shumicë në Kosovë. Ndërsa, në nivelin lokal secili komunitet jo shumicë përfaqësohet proporcionalisht me popullatën e përgjithshme në komunë. Në lidhje me përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë, institucionet e nivelit qendror dhe lokal përgatisin raportet periodike. Me nxjerrjen e Ligjit për shërbimin civil dhe Rregullores për përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë janë krijuar parakushtet për përfaqësimin e drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në Shërbimin civil të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, ke pyetje shtesë?
Regjia, fjalën deputetit Xhevdet Neziraj:

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

Pyetje shtesë ka të bëjë, sepse pyetja edhe ishte, se sa janë të punësuar në nivelin qendror, pjesëtarë të komunitetit egjiptian si shërbyes civil? Unë kam të dhëna tjera se ka shumë pak ose asnjë. Marrim shembull: në Kuvend, në administratë të Kuvendit s'është asnjë, në Ministri për Komunitete dhe kthim s'është asnjë, në Ministri të Shërbimeve Publike s'është asnjë dhe shumë e shumë tjera. Prandaj, po dua konkretisht në cilat ministri, ose në cilat shërbime janë këta të punësuar. Faleminderit!

KRYETARI: E ke fjalën.

Ministri i Administratës Publike, MAHIR JAGXHELLAR: Faleminderit!

Për këtë rast unë nuk kam strukturën për nëpër ministritë, por prej 28.838 të punësuarve në nivelin qendror, është një shpërndarje nëpër komunitete dhe është e dhëna nga institucionet zyrtare. Kështu që, shembull mundem me lexuar vetëm përqindjen e të gjitha komuniteteve ose në këtë rast për çdo institucion nuk kam të veçantë, por është në totalin 29 ose në përqindje 0.10%.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Donika Kadaj Bujupi, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaqi. Deputete e do fjalën?

DONIKA KADAJ BUJUPI: Kryetar, pyetja nuk është relevante, sepse është dorëzuar kohë më parë dhe do të thotë i ka kaluar aktualiteti. Ju faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit!
Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit Kryetar!

Meqenëse unë një herë e kam parashtruar këtë pyetje ministrit Rashiq, i cili mungonte. Ai prapë nuk është këtu. Besoj se tani është duke zgjidhur problemin, për të cilin unë e kam shtruar. Për punëtorët shëndetësor në Institutin special në Shtime, sepse kjo ka refleksion në gjithë shoqërinë kosovare. Shpresoj që është duke punuar në zgjidhjen e statusit të këtyre punëtorëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Lutfi Haziri, pyetje për ministrin Dardan Gashi.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit Kryetar!

E kam marrë përgjigjen me shkrim. Faleminderit dhe prej ministrit.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Goran Marinković, pyetje për ministrin Besim Beqaj. Deputet e ke fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče,

Pitanje nije aktuelno, jer je postavljeno pre nekog vremena i problem je rešen.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Duda Balje, pyetja për ministrin Ramë Buja. Deputete e ke fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem predsedavajući,

Pitanje je vrlo aktuelno, s obzirom na to da je na pomolu nova školska godina i pitanje za ministra glasi: zašto se odabrani materijal udbenika na nastavi na bosanskom jeziku ne otšampaju, kad su prošle sve faze predaje, prijema odabira procene, imaju saglasnost stručnih osoba – recenzenata, koji su dali svoje mišljenje o kvalitetu.

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar,

E nderuar zonja deputete,

Këtë përgjigje e kam marrë me shkrim para 3 javësh, apo më shumë se kaq dhe përgjigja është dhënë. Tash diçka ka lëvizur në kuptimin pozitiv të fjalës dhe të veprimit, duke u botuar disa nga ato tekste, për të cilat flisni ju. Por, megjithatë unë po lexoj përgjigjen në tërësi.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është duke punuar në krijimin e kushteve për arsim cilësor për të gjitha komunitetet. Në këtë drejtim që nga viti 2002 ka marrë për obligim përgatitjen dhe botimin e teksteve shkollore nga buxheti i saj për komunitetin boshnjak dhe turk. Në këtë drejtim janë siguruar 67 tituj të teksteve shkollore në gjuhën boshnjake, për nxënësit e klasës I – IX , të cilat janë shpërndarë falas. Gjithashtu, janë botuar edhe 62 tekste shkollore në gjuhën turke. E drejta autoriale, recensimi, lektorimi e të tjera, janë paguar nga buxheti i Kosovës. Për

grup autorësh dhe lëndësh kombëtare siç janë: gjuha boshnjake, gjuha turke, historia, arti muzikor dhe arti figurativ; ndërsa, tekste të tjera si matematika, fizika, kimia, biologjia, përkthehen nga gjuha shqipe në gjuhën boshnjake dhe në gjuhën turke për të gjitha klasat. Gjithashtu, janë paguar nga buxheti i Kosovës të gjitha këto tekste. MASHT në përputhje me Ligjin për arsim para universitar ka për obligim që të sigurojë tekste shkollore për të gjithë nxënësit prej klasës I – IX dhe atë obligim rregullisht është duke e përmbushur. Duhet të theksohet se dy herë është shpallur konkursi për grup lëndësh kombëtare nëpër gazeta ditore dhe në ueb faqen e MASHT-it, por, për fat të keq edhe pse konkursi ka zgjat 3 muaj, prapë se prapë askush nuk ka konkurruar për lëndët arsimore në... mësimore në të vërtetë, më falni, në gjuhën boshnjake, histori dhe edukatë muzikore për klasën V, VIII dhe IX. Ekziston një numër i teksteve shkollore për të cilat është dhënë pëlqimi nga ana e recensentëve dhe jemi të bindur që këto tekste do të botohen këtë vit dhe janë në proces të votimit. Me këto aktivitete MASHT-i po tregon vendosmërinë e vet për të përmbushur obligimet që ka ndaj këtij komuniteti dhe komuniteteve tjera pakicë në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë?

KRYETARI: Butonin, butonin, deputete.

DUDA BALJE: Ne, hvala! Zahvaljujem!

KRYETARI: Pyetja e fundit, deputetja Duda Balje. Pyetje për ministrin Slobodan Petroviq. Mund ta parashtroni pyetjen deputete.

DUDA BALJE: Biću vrlo kratka i pitanje je vrlo decidno. Gospodine ministre, vama se obraćam s obzirom da su srpska i turska zajednica dobila opštine, i to turska jednu a srpska više njih, a bošnjačka zajednica i pored toga što ispunjava sve uslove još nije dobila nijednu opštinu. Pitanje konkretno za vas. Da li vaše ministarstvo rasmišlja o tome i da li su na pomolu neki konkretni potezi za bošnjačku zajednicu?

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministër e ke fjalën.

SLOBODAN PETROVIQ: Poštovani Predsedniče Skupštine,
Premijeru,
Zamenici premijera,
Ministri,
Uvaženi narodni poslanici,

Želim prvo da vam čestitam početak rada, uvažena narodna poslanice gospođo Balje,

Vezano za ovo pitanje želim da vas obavestim vas i cenjenu Skupštinu da Ministarstvo Administracije i Lokalne Samouprave do danas je dobilo 7 zahteva za osnivanje novih

opština. Od **naselja**, odnosno različitih zona, koja se nalaze teritoriji Kosova, jedan od zahteva je zasnivanje nove opštine sa većinskim stanovništvom iz Bošnjake zajednice je selo Lečane, opština Prizren. Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave na osnovu zakonskog mandata i posle prijema ovih zahteva je preduzelo sledeće radnje:

- Formirana je unutrašnja Komisija za izradu dokumenata, načela i kriterijumi za osnivanje novih opština i izrađen je draft dokument. Posle izrade prvog draft dokumenta načela i kriterijumi za osnivanje novih opština, isti je prosleđen Međunarodnoj Civilnoj Kancelariji na neku eventualnu dopunu, onako kako i predviđa, kako se i predviđa članom 14., sveobuhvatnog predloga za rešenja statusa Kosova, odnosno paketa gospodina Martija Ahtisarija.

Ministarstvo Administracije i Lokalne Samouprave je pri kraju procesa osnivanja novih opština, predviđenih prema sveobuhvatnom planu predloga o statusu Kosova, odnosno paketa predsednika Ahtisarija i Zakonu o administrativnim granicama za osnivanje još jedne opštine odnosno opštine severna Mitrovica. S toga kao što nam je poznato, ni paket Ahtisarija niti Zakon o administrativnim granicama ne predviđa osnivanje novih drugih opština, osim ovih opština koje su osnovane, kao i osnivanje još jedne opštine – severna Mitrovica. Međutim mi smo zainteresovani i radimo na razmatranju svih zahteva o mogućnostima osnivanja novih opština, a koje trenutno nisu predviđene Kosovskim zakonima. Mi studiramo sve okolnosti za razna naselja, nadzirajući i specifičnosti svakog naselja i njihovim složenostima, za eventualne kriterijume koje ispunjavaju još neke druge opštine, koje su na prostoru Kosova. Ono što želim da vam kažem i na vreme u slučaju potrebe za formiranje novih opština, onda ćemo

KRYETARI: Ministër, e ke kaluar kohën. Deputete, ke pyetje shitesë?

(një zë: rezhijs)

DUDA BALJE: Zahvaljujem gospodine ministre, na informacijama, a ja bih da vas podsetim jedno. Znači mi nismo precizirali za opštinu Rečane samo, nego za opštinu Goru i za opštinu Vitomiricu, koje ispunjavaju takođe sve uslove, koji se traže Ahtisarijevim planom i aktuelnim zakonima koji važe na Kosovu, i ja ne znam odakle činjenica da Ahtisarijev zakon ne predviđa nove opštine. Ahtisarijev zakon govori o tome da, ukoliko se ispune uslovi onda postoji mogućnost za dobijanje novih opština. S obzirom na to da mi ispunjavamo uslove mi generalno tražimo samo ono što nam i pripada. Znači ako su se formirale u zadnjem vremenu, ne razumem zašto se ne bi i od sutra formirale već nove opštine druge. Za bošnjačku zajednicu konkretno je bilo pitanje.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

SLOBODAN PETROVIQ: Ja bih vam toplo preporučio da pročitate Ahtisarijev plan za formiranje nove opštine, ali nevezano za to, ono što je i želja i volja i Vlade i moja lično jeste da obezbedimo bolji život svakom građanu, koji žive na Kosovu, bez razlike na ime i prezime i bez razlike na nacionalnu pripadnost. Ono što ću se zajedno sa mojim kolegama u Vladi založiti da i građanima koji žive u tom delu Kosova, omogućimo da na

konkretan naçin obezbedi kvalitet žīvota. Da li će to biti u organizaciji nove opštine, to svakako ne zavisi samo od moje dobre volje, ali budite sigurni da Vlada Kosova ima za partnere građane Kosova. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, Ministër!

Dhe me këtë pyetjet parlamentare kanë përfunduar. Para se të fillojmë me pikën e 3-të të Rendit të ditës, kemi dy kërkesa. Fjalën e ka kërkuar deputeti Lutfi Haziri.

Deputet e ke fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit zoti Kryetar,

Unë e kam një kërkesë që pika e 10-të e Rendit të Punës për shqyrtimin e parë të Raportit të Progresit për planin e veprimit të shqyrtohet si pikë e katërt e rendit të punës me prioritet sot edhe për arsye që Komisioni gjatë ditës së sotme ka nevojë të takohet, ne veçanti për miratimin e disa ligjeve për seancën e ardhshme. Nëse e merrni në konsideratë këtë kërkesë, ju falënderoj.

KRYETARI: Një votim formal.

Kush është “kundër” , ... tri, katër vota “kundër”. Megjithatë, Kuvendi miratoi zhvendosjen e kësaj pike të Rendit të Ditës.

Deputeti Idriz Vehapi e ka kërkuar fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë

Kërkesa ime është që të futet në Rendin e Ditës, shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Ne si Komision funksional e kemi shqyrtua paraleximisht në parim më datën 19 të këtij muaji, dhe ky projektligj figuron në grupin e ligjeve që janë në Raportin e Progresit dhe do të ju kisha falënderuar nëse na jepet mundësia që të vazhdojmë me amandamentimin dhe projektligji të jetë gati për seancën e radhës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit,

Në seancë kemi 94 deputetë. Për të votuar këtë kërkesë ose këtë mocion duhet 2/3 e deputetëve prezentë. Nëse është vullneti i deputetëve që ky ligj të futet në lexim të parë në parim, unë po e qes në votim? Kush është “për” kërkesën që e bëri kryetari i Komisionit për Arsime Shkencë e Kulturë, Pushtet Lokal, Idriz Vehapi. Kush është “për”?

(një zë: nuk janë shumica . 52... kështu që s’ka nevojë...)

KRYETARI: Faleminderit,

Kërkesa juaj deputet nuk kalon, vazhdojmë me Rendin e Ditës. Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit!

KRYETARI: kanë votuar 52 deputetë, kështu që ta dini, por nuk i kanë plotësuar kushtet për t'u radhitur në Rendin e Ditës.

NAIT HASANI: Faleminderit Kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin. Unë kam një kërkesë nga Komisioni që të futen në rend të ditës ligji për ...

KRYETARI: Nuk po dëgjohesh, deputet!

NAIT HASANI: ... unë s'i kam fajet!

(një zë...)

NAIT HASANI: Është, komisioni ka shqyrtuar ligjin për mbeturina që është në Raportin e Progresit dhe Ligjin për të drejtën banesore dhe kërkoj nga seanca që ta futin në Rendin e Ditës për shqyrtim këta dy ligje në lexim të parë. Faleminderit!

KRYETARI: A i kanë plotësuar kushtet. Edhe për këto dy ligje kërkohen 2/3 e deputetëve prezentë. Cili është mendimi i grupeve tjera parlamentare... i Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, Kryetar!

Me gjithë respektin, ne kështu nuk pranojmë të futen ligjet dhe nuk e përkrahim një propozim të tillë.

KRYETARI: Vetëvendosja...

Deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, Kryetar!

Edhe ne jemi kundër që të futen këto dy ligje në seancën e sotme, për shkak që nuk kanë pasur deputetët kohë që t'i trajtojnë ato.

KRYETARI: Faleminderit, kalojmë në Rendin e ditës.

Pika e 3-të .

Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes Plenare të mbajtur më 28 dhe 29 korrik 2011. Të nderuar deputetë a keni vërejtje në këto procesverbale? Nuk ka.

Konsideroj se Kuvendi miratoi 3 procesverbalet e Mbledhjeve Plenare të mbajtura më 28 dhe 29 korrik 2011.

(një zë:.... pika 10)

KRYETARI: Tani vjen pika 10 e Rendit të Ditës.

Me propozimin e kryetarit të komisionit ...

Shqyrtimi i Raportit të parë të Progresit për planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrimet evropiane për vitin 2011. Komisioni për Integritet Evropian, në koordinim me komisionet tjera parlamentare ka hartuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Raportin e parë të Progresit për planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2011.

Ftoj kryetarin e Komisionit për integritet evropian deputetin Lutfi Haziri, që në emër të komisionit para deputetëve të Kuvendit të arsyetojë dhe prezantojë raportin.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar,
Zoti Kryeministër,
Anëtarë të Kabinetit,
Të nderuar deputetë,

Në emër të komisionit parlamentar, por dhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës ju ftoj që sot ta miratoni Raportin e parë të Progresit të paraqitur në tremujorin e parë nga ana e këtij komisioni në seancë.

Është obligim dhe është detyrë e vazhdueshme e këtij komisioni funksional të Kuvendit për të përcjellë, për të monitoru dhe për të raportu mbi gjendjen dhe arritjet që ky komision dhe institucionet e Kuvendit, po flas institucionet e Kuvendit, arrijnë me i realizu. Mund të shihni nga tabelari, pa indikatorë të caktum, por sipas periudhave kohore, plani i parë tremujorë është realizuar pjesërisht, për shkak se tremujori i parë fillon me u llogaritur prej prillit e tutje. Ne jemi në mungesë, një tremujor të humbur, i cili natyrisht do të kishte dhënë mundësi më shumë me u punu dhe më shumë me u raportu, dhe po ashtu duhet ta keni parasysh se deri më 1 shtator, komisioni funksional dhe ky Kuvend duhet ta miraton edhe një numër të madh të ligjeve në mënyrë që 12 tetori, atë ditë kur do të paraqitet Raporti Final për Kosovën këtë vit të përmbajnë tone më pozitive se sa raportet tjera. Unë mund të ju falënderoj për angazhimin, shumicën e kryetarëve të komisioneve, edhe pse ka nevojë që të përmirësohet performanca dhe koordinimi në kuadër të disa komisioneve, por është paraqitur në këtë raport. Ju faleminderit shumë! Dhe, besoj që raporti i dytë që do të paraqitet do të jetë më pozitiv se sa ky që sot e kemi paraqitur. Faleminderit shumë!.

Mbledhjen e kryeson nënkryetari i kuvendit Z. XHAVIT HALITI

KRYESUESI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

E hapi debatin lidhur me këtë,

Fjalën e ka përfaqësuesi i Qeverisë nëse dëshiron. Nuk është paraqitur askush. Kryetarët e komisioneve parlamentare. Të LDK-së nuk e kërkojnë fjalën. PDK...

(një zë: ... komisioni vjen tash)

KRYESUESI: Komisioneve...komisionet... a dojnë komisionet dikush prapë a?

S'ka! Kryetarët e përfaqësuesve të grupeve parlamentare ose përfaqësuesit.

Zoti Ismet e dëshironi fjalën?

(dëgjohen zëra.....)

KRYESUESI: Në emër t'grupit s'ka folë, në emër të komisionit... eee ... ani mirë.
Grupi parlamentar i PDK-së, Blerta.

BLERTA DELIU – KODRA: Faleminderit, Kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrahë në parim Raportin e parë të Progresit për planin e veprimit për partneritet evropian dhe fton edhe grupet tjera parlamentare që ta përkrahin këtë Raport. Faleminderit!.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “Vetëvendosja”. Deputeti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, Kryesues!

Edhe lëvizja “Vetëvendosje” e përkrahë këtë raport, i cili paraqet Progresin e Kuvendit, që deri tash t'i miratojë ato ligjet që kanë të bëjnë me Raportin e Progresit, por kryesisht edhe me marrëdhënien që Kosova ka me BE-në, por natyrisht që, prapë qëndron ajo që kemi thënë çdo herë ne që, është mirë që të miratohen ligjet, të cilat do ta përmirësonin jetën në Kosovë. Mirëpo, ne po ashtu e kundërshtojmë këtë nguti, nganjëherë edhe në miratimin e ligjeve vetëm për hir... për t'i plotësuar disa kërkesa nga Raporti i Progresit. Pra, pa e marrë parasysh fare atë që, për çka vërtetë nevojë Kosova, populli i Kosovës. E kemi parë, d.m.th. edhe gjatë pjesës së parë të këtij Kuvendi, kësaj Legjislature, që shpeshherë kemi debatuar për ligjet, të cilat madje as që janë të zbatueshme dhe nuk i kemi kurrfarë kushte për t'i zbatuar. Pra i kemi miratuar vetëm sa për të thënë që i kemi. Dhe kjo... Mendoj se kjo praktikë duhet të ndryshojë në këtë Kuvend, në mënyrë që Kuvendi vërtetë të jetë i Kosovës dhe të merret me interesin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi parlamentar i AAK-së, deputeti Gjini, a Blerim Shala?

BLERIM SHALA: Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e përkrahë në parim Raportin e parë që trajton këtë tematikë tepër të rëndësishme. Mendoj që me këtë raport i vihet një lloj kapaku një debati të panevojshëm, të pakëndshëm, që është zhvilluar kohëve të fundit në raportet midis Qeverisë dhe Kuvendit, kush është përgjegjës për miratimet e ligjeve, gjegjësisht për dinamikën, e cila nuk ka qenë adekuate, sipas Qeverisë, natyrisht edhe sipas Kuvendit dhe, që reflektohet me gjasë edhe në përmbajtjen e Raportit të Ri të Progresit të Komisionit evropian për Kosovën. Kuvendi edhe ashtu për bindjen tonë, me një shpejtësi marramendëse është duke i miratuar shumicën e ligjeve, pikërisht me qëllim që të përmirësohet imazhi i Kosovës dhe pozicioni i Kosovës në Komisionin evropian dhe krejt çka është dashtë të bëhet prej deputetëve të Kuventi është bërë. Por, do t'ua përkujtoja deputetëve që miratimi i ligjeve nuk është elementi i vetëm dhe as kryesori, madje, në cilësinë apo përmbajtjen e Raportit të Progresit janë mori masash, veprimeve e detyrash që duhet të kryhen. Dhe, me gjasë Raporti i Progresit është me përmbajtjen e tij udhërrëfyese më i mirë se cili duhet të jetë në fakt plani i qeverisjes së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi parlamentar Kosova e... Koalicioni Kosova e Re, deputetja Novoberdaliu.

SUZAN NOVOBERDALIU: Faleminderit, Kryesues!

Edhe Grup Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re e përkrahë raportin pa i përsëritur fjalët e parafolësve të... , sepse në disa gjëra pajtohem me thëniet e tyre dhe në parim e përkrahim. Faleminderit.

Grupi Parlamentar SLS, Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala gospodine predsedavajući,

I parlamentarna Grupa Samostalne Liberalne Stranke, podržava Izveštaj o Progresu za evropske integracije i glasaćemo za Izveštaj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “6+”, deputeti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit i nderuar kryesues.

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrahë këtë Raport të parë të Progresit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani kemi deputetët sipas radhës, deputeti Hidajet Hyseni ka kërkuar fjalën.

HIDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues,

Zonja dhe zotërinjë deputetë,

E mora fjalën jo vetëm për të mbështetur Raportin në fjalë, por edhe për të bërë një vërejtje, me të cilën besoj pajtohem edhe në Rendin e Ditës edhe në shkresën e komisionit. Por, edhe në paraqitjet e deritanishme u fol për shqyrtimin dhe miratimin e Raportit të parë të Progresit për planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrimet evropiane. Nuk ka raport të Progresit për planin e veprimit, por, ka plan të veprimit për Raportin e Progresit, plan të veprimit të Kuvendit që lidhet me Raportin e Progresit. Mendoj që do të duhej të korrigjohet siç është edhe në fakt në tekstin e shpërndarë të planit të veprimit dhe Raportit të ... lidhur me planin e veprimit që lidhet me Raportin e Progresit. Kaq kisha, ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues,

Unë, normal, e mbështes këtë raport. Ajo që dëshiroj të them është diçka, që ndoshta mund t'i shërbejë komisionit ose për raportin vijues që ka të bëjë kryesisht me formatin e raportit. Siç e dini kjo është një formë tabelare e raportimit, kështu raportojnë shumica, ose gati të gjitha institucionet në raport me Raportin... me planin e veprimit për partneritet evropian dhe kryesisht shënohen ato që bëhen, dhe, ka disa prej të dhënave që

janë, varësisht prej kur është krye ndonjë veprim i caktuar nga institucioni i caktuar. Ajo që na mungon është që do të duhej, për çka unë po e marr fjalën, është që të jetë një pjesë tjetër shtesë e fundit me rekomandime dhe që ka të bëjë me fokusin tonë në veprimet, të cilat nuk janë realizu ose ka gjasë që mund të vonohen. Të thuhet disa rekomandime, të theksohen sfidat që janë, qofshin ato në mungesë të kapaciteteve që i kemi, në mungesë të bashkëpunimit ndërinstitucional me faktorin ndërkombëtar, etj., në mënyrë që do t'i ndihmonte institucionet, komisionet e caktueme të fokusohen më shumë dhe kryesinë e Kuvendit, ndoshta, ta angazhojnë më shumë kapacitete në ato sfera për çka ka nevojë më shumë dhe për çka mund të priten vështirësi ose pengesa në realizimin e asaj sfide. Ju faleminderit shumë!.

KRYESUESI: Faleminderit!

Nënkryetari i Kuvendit, deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zotni kryesues Haliti!

Përshëndetje për ministrat që janë këtu,

Përshëndetje për kolegët deputetë,

Ky është një tremujor i një plani të veprimit që Kuvendi i ka ngarkuar vetvetes për detyrë në programet e veta dhe ka filluar të bëhet raport i rregullt. Natyrisht, që unë do ta votoj këtë raport, nëse jo për analizë të tij, për skemën e cila ka filluar të bëhet konkrete dhe më në fund të mos kemi retorikë boshe rreth temës së famshme të programeve të integritimit evropian, por, më në fund të lexojmë të dhëna. Këtë raport pra, unë e përkrah për shkak se ka kriju skemën e evidentimit të të dhënave.

Dhe, nën 2, siç e tha kolegu Shala, është mirë që të shihet më në fund. Të kalojmë të merremi me të dhënat, se ai që nuk merret me të dhënat, shpikë të dhëna dhe krijohet një tip i zhurmajës politike, e cila e ka populluar komunikimin publik në këta muajt e fundit rreth Qeverisë dhe rreth Kuvendit kur ka të bëhet me pjesën legjislative. Edhe Kuvendi edhe opinionin duhet ta dinë, që ekziston një rregull qysh miratohen ligjet, ekziston një rregull qysh miratohen edhe ligjet kur Kuvendi don t'i përshpejtojë. Por, duhet të... përfundimisht të përcaktohem, a jemi për të bërë numra që vijnë si kërkesa ultimative, apo jemi për të bërë ligje të besueshme dhe të dobishme. Ky është një debat i rëndësishëm dhe ka dalë rreth Kuvendit, sidomos këtë muajin e fundit. Dhe, ju keni parë që ju keni instanca, varet prej kujt vinë, që mendojnë se numri është vlerë dhe, të tjerë që mendojnë se vlera është vlerë. Dhe, ju e dini që që tash ne kemi nga Bashkimi Evropian, nga zyra e tyre, kërkesë që "iks", "ipsilon", "zet" ligji, që hyn në ato që quhen ligje prioritare, mos u ngutni, po krijoni kualitet. Këtë po e theksoj se edhe këtu sot ne patëm dy-tri intervenime, që duhet të ngutemi për shkak se janë në listë të ligjeve dhe, në të njëjtën kohë, po sot ose nesër ne do të na dalë kërkesa e zyrës së BE-së, mos i ngutni këto ligje. Pra, për të sqaruar këtë problematikë e mora fjalën dhe, edhe një herë për të thënë: Mbështes raportet që japin të dhëna. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Amir Ahmeti e ka fjalën.

AMIR AHMETI: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Unë kam vetëm dy vërejtje të vogla. Në herën e parë kur kemi diskutu për Raportin e Progresit, tek kapitulli i dytë për të drejtat e njeriut, ku flitet për miratimin e kornizës ligjore, që mundëson lirinë dhe aktivitetet fetare. Te veprimet e ndërmarra parashihet që më 1 dhjetor në Kuvend do të diskutohet, por te veprimet e propozuara, unë kam propozuar herën e kaluar që te veprimet e propozuara të konsultohen bashkësitë fetare për këtë ligj, sepse nëse ne në dhjetor vijmë diskutojmë ndërsa, paraprakisht për këtë veprimtari nuk i kemi konsultuar bashkësitë fetare, atëherë nuk e di me çfarë të drejte ne do të bëjmë ligje kur nuk e njohim atë fushëveprimtari. E para, dhe E dyta - te faqe 26. p.43 vetëdija për çështje të lezbikëve, ose homoseksualëve, biseksualëve ose transgjinerëve. Këtu unë kam kërkuar që te veprimet e propozuara të kihet parasysh edhe Ministria e Shëndetësisë për të shëruar këto vese të shëmtuara, e jo të shkruhet se nuk ka progres në këtë raport, kur shqetësimin e kam shprehë gjatë shqyrtimit të raportit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Mendoj që Kosova është shtet laik, dhe, feja është e ndarë nga institucionet dhe nga shkolla dhe nuk është mirë me na u komplikoj këto çështje as me ia komplikoj vetvetes për arsye që dikujt i intereson. Ne po vazhdojmë të miratojmë ligjet në bazë të Kushtetutës, dhe, uroj që sa më shpejtë edhe Ligji mbi fetë të vijë në Parlament, të miratohet dhe edhe komunitetet fetare t'i nënshtrohen ligjeve të Kosovës. Mos të jenë mbi ligjet dhe s'duhet të jenë mbi ligjet. Faleminderit!

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e Raportit të parë të Progresit, për planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian për vitin 2011.
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tani.

Konstatohet se në sallë janë 78 vota... 78 deputetë, më falni!

Konstatohet se me 69 vota "Për", 1 abstenim, dhe 1 "kundër", Kuvendi miratoi Raportin e parë të Progresit për planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian për vitin 2011.

Atëherë, vazhdojmë sipas radhës, meqenëse bëmë spostimin, tani vazhdojmë me pikën e 5-të të Rendit të ditës, që është:

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregti me jashtë.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj ministrin ...

(një zë: zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, se ka ndryshu)

Ftoj zëvendëskryemministrit, Kuçi, që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Kuçi, e keni fjalën.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Anëtarë të Qeverisë,
Zonja dhe zotërinjë,

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të prezantoj projektligjin për tregti me jashtë.

Që nga viti 2002 kjo fushë është rregulluar me Ligjin, që ka qenë në fuqi, me Ligjin për aktivitete të tregtisë me jashtë. Mirëpo, me qëllim të përafrimit të këtij Ligji me legjislacionin e BE-së dhe me rregullativën e Organizatës botërore të tregtisë, ky Ligj ka hyrë si prioritet në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në hartimin e një ligji të ri. Arsyeja për ndryshimin e ligjit është përmbushja e objektivave të Qeverisë së Kosovës në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe shtimit e vëllimit të tregtisë së jashtme, si dhe krijimin e lehtësirave procedurale në fushën e tregtisë me jashtë, me qëllim që ky projektligj të jetë sa më praktik dhe më lehtë i zbatueshëm. Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i rregullave të përgjithshme në ushtrimin e tregtisë me jashtë, përcaktimi i procedurave dhe kriterëve të importit, eksportit dhe transitit të mallit, shërbimeve dhe pasurive kapitale. Fushëveprimi i këtij projektligji është blerja dhe shitja e mallrave dhe ushtrimi i ndërmjetësimit tregtar në tregun e brendshëm dhe në atë të jashtëm.

Tregtia me jashtë zhvillohet në baza kontraktuale, në mes të tregtarëve me vendbanim në Republikën e Kosovës dhe personave me vendbanim jashtë Republikës sonë.

Me këtë ligj rregullohet veprimtaria tregtare, që mund të ushtrohet nga personat vendor dhe ata të huaj, nga personat fizik dhe juridik të regjistruar në pajtim me ligjin përkatës për ushtrimin e aktiviteteve tregtare. Projektligji e ka bazën në Organizatën Botërore të shëndetësisë dhe në Marrëveshjen mbi barrierat teknike në tregti, që synon të sigurojë që rregullat teknike, standardet dhe procedurat e vlerësimit të konfirmimit, të mos krijojnë pengesa të panevojshme në tregtinë ndërkombëtare.

Marrëveshja njeh të drejtën e shteteve për të miratuar masat e tilla, me qëllim të përmbushjes së objektivit të ligjshëm, p.sh. mbrojtjen e shëndetit të njeriut, sigurinë apo mbrojtjen e mjedisit. Rregullat teknike dhe standardet nuk duhet të kenë karakter diskriminues në mes të produkteve vendore dhe atyre të ngjashme të importuara.

Hyrja në fuqi e këtij ligji do të ketë efekte pozitive në fushën e tregtisë, duke marrë parasysh sigurinë e mallrave, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, të kafshëve dhe bimëve, mbrojtjen e mjedisit dhe të natyrës, të cilat kanë për qëllim fushëveprimin brenda këtij ligji.

Më lejoni që, duke ju ftuar që ta përkrahni këtë projektligj të jepni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja, në mënyrë që të miratohet sot në lexim të parë dhe të procedohet për më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kuçi.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit zoti kryesues,
Zoti zëvendëskryeministër,
Ministra,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në mbledhjen e mbajtur të datës 19.07.2011, e ka shqyrtuar në parim këtë projektligj, dhe, ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit por miratim në parim. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani sipas radhës janë kryetarët e komisioneve.. kryetarët e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Pula e ka fjalën.

JUSTINA PULA: Faleminderit, kryesues,
Zotni zëvendëskryeministër,
Ministra,
Deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji është hartimi i bazës ligjore për tregti me jashtë. Grupi Parlamentar i PDK-së ka analizu dhe diskutu këtë projektligj dhe në parim e përkrah. Komentet rreth këtij projektligji dhe kontributin Grupi Parlamentar i PDK-së nëpërmes të përfaqësuesve të vet do të ofrojë në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputetja Teutë Sahatqija. ... apo... a me kartelë të Nazana Brecës...

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Me përpilimin e Ligjit për tregti me jashtë është menduar të zëvendësohet Ligji për aktivitetin e tregtisë me jashtë 2002/6. Në pjesën përcjellëse të ligjit nga ana e ministrive dhe departamenteve të ndryshme thuhet se ky ligj nuk ka kosto shtesë buxhetore, por zbatimi sigurohet nga ndarja buxhetore e MTI-së. Është në përputhje me “aqui-comunitaire”, me rregullat e OBT-së, direktoratin gjeneral për tregti të BE-së dhe në pajtueshmëri me politikat Qeveritare. Ka 32 nene, dy kapituj, atë të importit dhe të eksportit.

Ky ligj, duhet të përcaktojë rregullat për ushtrimin e tregtisë, importit, eksportit, transitit, shërbimeve dhe si thuhet, në Formularin e Vlerësimit të ndikimit rregullativë: edhe përcaktimin e pasurive kapitale apo ndërmjetësimit tregtarë, gjë të cilat aspak nuk përmenden por, ligj që Qeveria e ka notuar me notën 5 apo shkëlqyeshëm. Projektligji në nenin 2.3 dhe 3.1.6, nuk dallon personat fizikë apo juridik vendorë apo të huaj, të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë në Kosovë, gjë që është mirë për biznes dhe investime.

Nga neni 5 deri në 8, flitet për Masa Kufizuese, autoritetin për zbatimin e masave dhe rregullat e përgjithshme lidhur me licenca, ndonëse nuk caktohen këto masa. Lëmi kjo e cila, në masë të madhe trajtohet nga Ligji për Masat Mbrojtëse në Import dhe nuk ka nevojë të dublikohet me këtë ligj.

Neni 7, rregullat e përgjithshme lidhur me licenca për eksport dhe import, edhe pse përmendet fjala “Licencim” nuk ka referim në nenin i cili flet për kritere, ku kërkohet dhënia e licencës për import apo eksport.

Neni 9, bën fjalë për: shpërndarjen e kuotave, të cilat Qeveria përcakton kushtet më të përafërta për ndarjen e kuotave, numrin për ndarjen e kuotave etj.

Pa treguar qëllimin e përdorimit të tyre, kur duhet dhe me çfarë kriteri përcaktohen kuotat, por vetëm kriteri se si do të shpërndahen ato. Është e pa qartë se pse në një vend me tregti të lirë, duhet të vendosen kuotat dhe kjo në këtë rast vetëm mund të inkurajojë ciklin e Korrupsionit për kompanitë e preferuara për Qeverinë.

Neni 11.2, “ Zbatimi i marrëveshjes ndërkombëtare”

Është vendosur zbatimi i reciprocitetit dhe neni i cili flet që është vendosur shpejtë e shpejtë aty, për të përputhur me aktualitet e sotme dhe nuk e ka fare vendin aty, sepse kjo çështja adresohet në materialin e marrëveshjeve ndërkombëtare, e jo në Ligjin për Tregti me Jashtë.

Neni 14, paragrafi 1,2 dhe 3, flet për: “Kërkesat teknike për mallrat e importuara” dhe obligimin e atyre produkteve për përmbushjen e kërkesave të konformitetit. Ky nen, si dhe neni përpara, si ai në Ligjin për Mbrojtjen e Importeve, ka konflikt me Ligjin për Kërkesat Teknike të Produkteve dhe Vlerësim të Konformitetit. Çudia vazhdon kur, në të njëjtin nen, paragrafi 4, i cili për habi thotë:” Kushtet nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, nuk mund të kenë pasoja të kufizimit të importit apo transitit. E pse pra, janë paragrafët 1,2 dhe 3, kur neni 4 i kundërshton ato.

Pra, edhe nëse nuk i plotëson kushtet e konformitetit ato mund të importohen, gjë e cila përsëri bie në konflikt me Ligjin për Konfirmimet, po bien në konflikt me vetveten.

E njëjta gjë, vazhdon me nenin 15, ku paragrafët 1 dhe 2, caktojnë kushtet teknike ndërsa paragrafi 3, thotë se : “ Standardet dhe Konformiteti nuk janë parakusht për import të mallrave”, pse pra janë në nenin 1 dhe 2.

Neni 17, thotë se: “ Nuk ka nevojë për licencë importi apo eksporti përveç, për ato mallrat të listës së kontrolluar”.

Neni 18.

Lista e importeve të kontrolluara, vazhdon praktikën e kundërshtimit të paragrafëve mes veti. Njëjtë si më parë, neni 1, 2, 3 flasin për: licenca, mallrat nga lista e kontrolluar, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, sigurisë së vendit të kafshëve etj, dhe sipas zakonit

të çuditshëm të këtij ligji, paragrafi 4 thotë:” Lista e importeve të kontrolluara nuk duhet të jetë pengesë për qarkullimin e lirë të mallrave apo të masës kufizuese”. Çka do të thotë kjo? Pse atëherë ekziston nevoja për Listën e Kontrolluar?

Neni 30- Licenca për Transportet e shumëfishta, përcakton sasinë e lejuar brenda një viti. Gjë e cila, lë shumë gjëra të paqarta dhe të pa definuar.

Neni 32 – Transaksionet e shërbimeve është margaritar në veti, i cili më tepër ngjason në një manifest politik se sa në një Ligj për Tregti me Jashtë. Që me këtë rast, Qeverinë e definon si “ Ofertues të shërbimeve”.

Ta lexojmë paragrafin 3 të nenit 32, thotë: “ Asgjë nuk mund ta ndalojë Qeverinë që të ofrojë shërbime sipas avantazheve të shteteve fqinje, për të lehtësuar kufizimet e shkëmbimeve të njëjta të shërbimeve në zona kufitare e që janë të prodhuara dhe të konsumuara në vend”.

Sa prej jush e keni kuptuar këtë nen më së pari, se çka po d.m.th?

Ky ligj, është ligj me një gjuhë të pakuptimtë, pa lidhje logjike në mes pjesëve, me pjesë që bien në kundërshtim me vetveten edhe me ligjet tjera dhe duket si një ligjëratë e humbur në përkthim. Fitohet përshtypja, se një ligj i huaj është fut në Google Translate dhe çka ka dalë, ju ka seruar deputetëve.

Është një shembull i keq, i cili nuk duhet të përsëritet në të ardhmen dhe nuk e voton as të votohet, nuk e meriton të votohet, e assesi të notohet me notën e shkëlqyeshme, 5.

Grupi Parlamentar i LDK-së, nuk mund ta aprovojë as në parim këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI : Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ligji për Tregti me Jashtë, të cilin e kemi përpara këtu dhe për të cilin po kërkohet ose i cili po kërkohet të miratohet nga ne. Është një ligj, i cili mendoj se është i duhur për Kosovën, për shkak se e rregullon një sferë shumë të rëndësishme se deri tash ka qenë në një masë kogja e parregulluar, qoftë për shkak të mungesës së legjislaturës, por qoftë edhe për shkak të mungesës së vullnetit politik të institucioneve për ta rregulluar këtë fushë.

Natyrisht, që zhvillimi ekonomik është jashtëzakonisht i lidhur me tregtinë dhe me mënyrën, se si tregtojnë vendet në mes veti. Këtu në Kosovë, këtë e kemi parë duke na dëmtuar kjo tregti ashtu e hapur dhe pa kurrfarë kufizimi, kemi parë duke na dëmtuar ekonomikisht tash e 12 vjet. Fatkeqësisht, ky ligj nuk është kushedi çfarë ndryshimi nga realiteti të cilin e kemi tash dhe nuk parasheh ndonjë, të them ashtu, masë që do ta ndryshonte këtë, përveç në disa raste ku Qeveria apo ministria në fjalë, i jep mundësi vetës që ta kufizojë tregtinë e një malli të caktuar nëse ai mall, ose nëse vlerësohet se po e dëmton tregun e vendit edhe nëse vlerësohet se po e dëmton balancën tregtare, të, të

Kosovës. Gjë që mendoj që është një hap, kisha me thënë ashtu i mirë, po qe se zbatohet dhe po qe se vërtetë e ka Qeveria seriozisht.

Unë e pash këtu, prezantimin që e bëri Zëvendëskryeministri për ligjin dhe një gjë që është mjaftë brengose, e konsiderojë unë, në mënyrën se si po prezantohen ligjet, jo vetëm në këtë rast, por n'përgjithësi është se më shumë po ju jepet, shumë më shumë po ju jepet hapësirë racionale se ligjet që mbështeten në qoftë rregullat e ndryshme ndërkombëtare apo në ndonjë fakt tjetër jashtë Kosovës, sesa që po na tregohet faktikisht një logjik edhe një analizë e rrethanave të Kosovës, dhe se ky ligj do ta përmirësojë atë rrethanë.

Pra, këtu nuk u fol shumë se, çfarë ndikimi do ta ketë ky ligj në rregullimin e tregut të Kosovës dhe tregtinë e Kosovës me jashtë por, më shumë u flit për atë sesi, ky ligj është në përputhje me Organizatën Botërore Tregtisë me bashkimin evropian, e kështu me radhë, gjë që natyrisht që është e rëndësishme, nuk po them që nuk është e rëndësishme por, nuk mund të jetë më e rëndësishme sesa interesi i vendit dhe rrethanat e vendit.

Organizata Botërore e Tregtisë, natyrisht e merr parasysh nivelin e zhvillimit të vendeve dhe jo të gjitha rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë, aplikohen në të gjitha vendet në mënyrë të njëjtë, p.sh. ato vende që konsiderohet që kanë të hyra shumë të ulëta, lejohet që ta kenë një masë të caktuar të mbrojtjes së tregut të tyre dhe mbrojtjes së industrisë së tyre, deri sa të arrihen në nivel të zhvillimit ekonomik në mënyrë që të jenë të gatshme apo të munden që të garojnë me, të jenë konkurrense me prodhuesit tjerë. Kjo gjë nuk po shihet në këtë ligj, pra nëse këtë rregull nuk e ka përfillur fare Qeveria e Kosovës atëherë, kjo nënkupton, Qeveria e Kosovës mendon që Kosova vërtet e ka arritur nivelin e zhvillimit, pra është qind për qind konkurruese në treg dhe rrjedhimisht po e hapim tregun në mënyrë që ta, në realitet ta shkatërrojmë ekonominë apo prodhimin vendor.

Janë dy çështje të cilat kisha dashtë me i ngritë, përveç atyre që tashmë u ngritën në këtë seancë, që kanë të bëjnë me ligjin. Është pra, në njërën anë pra, prapë po na përcillet e njëjta logjik e një filozofie të caktuar zhvillimit ekonomik apo një filozofi e caktuar të rregullimit ekonomik që po quhet neo-liberale që është, sheshësia.

Pra, trajtimi i njëjtë i të gjithëve në treg pavarësisht se nga vijnë, pavarësisht se çfarë tregtojnë dhe pavarësisht se çfarë ndikimi kanë në tregun e Kosovës.

Edhe këtu, me këtë ligj parashihet që mallrat e jashtme, mallrat që prodhohen jashtë do ta kenë trajtimin e njëjtë me mallrat që prodhohen apo prodhimet që prodhohen brenda Kosovës, natyrisht që kjo është d.m.th një faktor shumë i rëndësishëm që e dëmton rëndë prodhimin vendor, gjë që e kemi parë të ndodh deri tash e 12 vjet.

Ndërkohë, që çështja tjetër është, po ashtu parashihet me ligj që njëherit prej neve do të thotë që, megjithatë Qeveria ka të drejtë dhe i lejohet Qeverisë që të merr trajtim ose të aplikojë trajtim të veçantë për një shtet të caktuar, gjë që konsiderojë që nuk është e keqe pra, natyrisht që ne nuk mund të kemi marrëdhënie të njëjta tregtare me të gjitha shtetet edhe kjo domosdo varet me marrëdhëniet politike që i kemi me ato shtete, por edhe me d.m.th nivelin e zhvillimit të atyre shteteve në mënyrë që në tregtinë reciproke të mund të

jemi të barabartë me ato shtete, me të cilat hyjmë në marrëdhënie tregtare mirëpo, është e çuditshme sesi në njërin anë ligji thotë që” mallrat vendore do të trajtohen si mallra të huaja, ndërkohë që i njëjti ligj pastaj i jep favore një shteti t’caktuar”. Pra, ne mund ta favorizojmë një shtet të caktuar në tregti, por jo shtetin tonë dhe kjo është mendoj, absolutisht e palogjikshme. Se nëse do të kishte favorizime, që unë mendoj që duhet me pas, atëherë këto favore duhet të nisin prej prodhuesve vendorë e pastaj të kemi favore natyrisht për shtetet mike të Kosovës, apo ato shtete të përzgjedhura me të cilat e kemi ndërmend të hyjmë në marrëdhënie tregtare.

Pra, konsiderojë që ky ligj, megjithatë e ka një bazë të pranueshme dhe lëvizja “Vetëvendosje” në parim do ta përkrahë mirëpo, këto vërejtje që i kemi edhe që janë kogja vërejtje substanciale për ligjin, do të tentojmë që t’i shtyjmë përmes komisioneve dhe nëse ato nuk rregullohen, se këto çështje nuk rregullohen, atëherë unë dhe ne si grup parlamentar nuk mund të garantojmë që do ta miratojmë këtë ligj në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zëvendëskryeministër,

Mendoj se i kemi edhe disa elemente tipike, d.m.th të qeverisjes së njëjtë e cila vazhdon përmes këtij ligji dhe arsyeja pse po dal para jush është se, është jashtëzakonisht me rëndësi për ta nënvizuar gjithë këta do të thotë që po ndodh, e kemi një situatë në të cilën Qeveria e Kosovës është jashtëzakonisht serioze kur punon për interesa personale të njerëzve, nuk i ik asnjë milimetër, përderisa kur punon për shtetin, e shkruajmë minimumin e seriozitetit, faktikisht është zero seriozitet, për shkak se nuk ka lidhje të hallkave as në administratë, e cila punon, nuk ka lidhje të hallkës mes administratës dhe pjesës politike do të thotë, pjesës së njerëzve që zgjidhen dhe defenitivisht që mungon tash lidhja e kësaj hallke mes ekzekutivit, njerëzit që janë zgjedh, tu thon ministrave, Kryeministri dhe Kuvendit të Kosovës, nuk ekziston absolutisht hiq. Ka mekanizma tjerë të cilët i vnojnë në funksion këto lidhje dhe ata mekanizma tjerë janë të mbrapshtë dhe na sjellin situata jashtëzakonisht të këqija.

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës, para jush disa herë kam kërkuar që Agjencioni Anti-Korrupsion të shndërrohet në agjension e jo në zyre që i mbledh formularët tonë, të deponuar të pasurisë edhe vetë ia huqim sesa na kushton vetura, një mëngjes na kushton 10 mijë, një mëngjes 15 mijë.

Mirëpo, të shndërrohet në një agjension, i cili ka për t’i studiuar ligjet që prodhohen në Qeveri dhe ka për t’i rekomanduar Kuvendit të Kosovës, se a lënë këto ligje hapësirë për korrupsion, do të thotë që korrupsioni të luftohet dhe në mënyrë sistemoreje vetëm të thuhet që një njeri është i korruptuar jo një tjetër nuk është dhe ta mbyllim me këto far konstatime shumë subjektive, do të thotë, duhet të bëhen të dyja, duhet edhe të zihen ata që abuzojnë me paranë publike por, edhe duhet të bëhen ligje të tilla që e minimizojnë mundësinë që dikush të abuzojë me paranë publike.

Do të thotë, logjika është, ne mund të bëjmë çfarë ligje dojmë, nuk është me rëndësi qysh punojmë na për shtetin, se punët tona i kryen dikush tjetër, e në të njëjtën kohë politika e Kosovës është e mbushur me retorikën, të silleni si shtet. Mu sjell si shtet është të prodhojmë ligje për shtetin, ligje normale, ligje të mira, jo vetëm me bo fjalë e pallavra në televizion.

Po kthena, për t'i vërtetuar këto që i thashë, kapak-kapak, kam me provu mos me i përsërit, kolegë deputetë që folën ma përpara. Fillimisht Komisioni për Legjislacion, nëse ky ligj kalon në parim do të duhej të merret me atë se, a është ky ligj në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, edhe po ju lexoj paragrafin 3, të nenit 119, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, është shumë i shkurtër, thotë kështu: “ Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë, përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese ose praktikave që kufizojnë konkurrencën janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj, eksplicit e lexova. Kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj”- kështu thotë Kushtetuta e Kosovës, neni 119, paragrafi 3, Zëvendëskryeministri ka qenë Kryetar i Komisionit Kushtetues.

Ndërsa, në nenin 5 dhe 6, thuhet: “Qeveria ka mundësi me aktet nënligjore me vendosë masa”. Nuk kërkohet të paktën që masat e tilla, të kërkohen të vendosen nga Kuvendi i Kosoves. Qeveria i jep vetes, kompetenca që dalin jashtë kompetencave të cilat ia ka dhënë Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe kjo është ajo çka ndodh me ligjin në total, në vazhdimësi.

Nëse i shohim elementet tjera të ligjit p.sh. e kemi nenin 11, u tha më përpara këtu, vetëm për shkak se ka ndodh një veprim për reciprocitet, veprim të cilin opozita e ka lyp që 2 vjet e gjysmë, tu e tregu të vërtetën, d.m.th nuk ka qenë kurrfarë heroizmi, vendosja e masave të reciprocitetit, përkundrazi, ka qenë një fyerje dy vjeçare që i ka ndodh Kosovës që ato masa nuk janë vendosur në momentin kur Serbia na ka vendos neve dhe tash, glorifikohen ata që janë vonuar dy vjet e gjysmë edhe plus futet një nen në ligj, kinse të legjitimojë vendosjen e masave të reciprocitetit. Pse, a nuk paskan qenë ligjore këto masa që janë vendosur më përpara por, duhet një nen i ligjit për me i vendos këto masa? Kujt i ka ra ndërmend ky gjenialitet që e përdori dikush fjalën “ gjenialitet”.

Neni 13, flet për trajtimin e shtetit më të favorizuar e të njëjtën gjë e bën në nenin 23, do të thotë, ka provizione që flasin për të njëjtën temë, janë shpërndarë si provizione, për shkak se ligji është hartuar në mënyrë të çuditshme, kujt i ka ra ndërmend, ka qitë diçka tjetër.

Tash, po ju them diçka për trajtimin e shtetit më të favorizuar. Shtete shumë të mëdha, shembull të marrin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e kanë një ligj të shteteve më të favorizuara, a e dini pse? Për shkak se, nëse atyre ju teket me i ble krejt lëngjet e pemëve që prodhohen në Kosovë, i marrin edhe krejt çka prodhojmë ne nuk mjafton për me i qit vetëm ka një litër, në krejt supermarketet e vetëm një shteti të vogël federal. D.m.th me bo me na ble ata neve prodhimet, na bëjmë çirak. Ata kanë mundësi për t'i ndihmuar dikujt, nëse e shpallin shtet të favorizuar, në marrëdhënie tregtare.

Qysh mundemi të favorizojmë ne dikon? Ne mundemi ekskluzivisht me bër reciprocitet me dikon që na mëshon fort, por duhet me ditë pak, d.m.th. madhësia është shumë e

rëndësishme, madhësia e shtetit. Me ia vnu veshin pak, sa mundemi me e ble na dhe qysh mundemi ne me vendos, për të favorizuar dhe me shpall shtetin më të favorizuar?

Edhe kjo është njëfarë sistemi i çuditshëm i të menduarit, thu ti se Kosova është diçka tjetër prej asaj që është, d.m.th njih vetveten, njih Kosovën njëherë, se për ta bërë më të mirë duhet ta njoh, jo me pa ëndrra.

E kemi nenin 15, te kushtet teknike, u tha më përpara. Shumë çuditshëm, gjuhet një paragraf jashtëzakonisht interesant, i cili thotë: “Standardet dhe kornformiteti, nuk janë parakushte për importimin e mallrave” vetëm kaq, d.m.th nuk ka rrjedhë logjike, nuk rrjedh prej ndonjë kapitulli, nuk rrjedh prej ndonjë grumbulli të neneve të cilit do ta kishin rregulluar këtë aspekt, por nuk vendosen kushte, por vetëm hidhet një paragraf i cili me siguri mundet me i shërbyer dikujt në të ardhmen, me importua çka të dojë edhe me thonë: “shikoni e keni kaluar një ligj” ku një paragraf eksplicit i ligjit thotë: që nuk ka nevojë për kurrfarë parakushte, d.m.th definitivisht që bie ndesh me shumë ligje tjera, shembull ta marrim, e kemi Ligjin për duhanin, i cili thotë, tash: mos më nxini për fjalë por e cakton normën e nikotinës edhe të katranit, në produktet në të cilat prodhohen dhe tregtohen në Kosovë.

Tash, nëse e kemi një ligj i cili e përcakton këtë kusht, që është kusht, definitivisht kusht për normën e nikotinës edhe për duhanin që prodhohet edhe tregtohet. Një nen tjetër i një ligji thotë: nuk ka nevojë me pas kesi kushti, ose p.sh. veturat, ne veturat i importojmë edhe e kemi njëfarë barrierë që humb me disa masa administrative, ndërsa tash një nen i ligjit thotë: bo çka të duash, se kushtet teknike nuk vlejné, as kriteret tjera.

Fundi i fundit, po më duket që duhet ta përfundojë edhe më shpejtë, për shkak se edhe nuk vlen me ju shku gjitha neneve, u thanë më përpara. Është ligj shumë i çuditshëm, një ndër ligjet më të çuditshmet që na kanë ardhur në Kuvendin e Kosovës, një ndër ligjet që definitivisht ky Kuvend nuk guxon me i kalu, se po tallet me vetveten, po tallet me popullin kur po kalon kesi ligje. Shihni edhe nenin 31, paramendoni ju çka rregullon neni 31. Prapë i ka ra ndërmend dikujt aty që ka qenë, me siguri përfaqësuesi i Ministrisë së Kulturës, ose kushedi se çka, edhe ka thënë: duhet edhe unë me bë diçka, se nuk guxoj unë me qenë pjesë e Grupit Punues, e asnjë nen mos me qenë që nuk e kam futur unë edhe nis me i rregulluar me këtë ligj, eksportimin e mallrave të cilat kanë vlera artistike dhe kulturore, ose p.sh. Qeveria e Kosovës, përmes këtij ligji, kërkon që eksportuesit e Kosovës, t’i prodhojë dokumentet e përshtatshmërisë fito-sanitare etj, etj, d.m.th kërkojmë kushte për eksportin tonë. Kushtet i lypin ata që blejnë. Nuk ka nevojë Kosova me ju vendos kushte eksportuesve të vet. Nëse dikush në botë lyp me ble lakra të prishura, ne duhet t’ia mundësojmë me i shit lakrat e prishura Kosova, pse na me i ndalë, nëse dikush tjetër don me i ble. Pse ne të kërkojmë kushte, për eksport? Përpos nëse definitivisht mallrat janë mallra, të cilat ne nuk dojmë me i eksportu se kemi ndonjë mall të rrallë, najfarë kuorce që nuk është gjend kërkund në botë edhe dojmë me ia rrit çmimin. Por, nuk kërkojmë pushtet fito-sanitare na, blerësi i kërkon, thotë: kjo është logjika e ligjit, këto shkruhen në ligj, krejt këto çka i përmenda unë edhe funi i fundit e përmenda në fillim, Agjensioni Antikorrupsion.

Ky ligj po dëshmon që nuk ka lidhje sesi punojmë na, edhe përmes këtij ligji edhe njëherë hapen dyert e mëdha të korrupsionit. Ky ligj monopolizon licenca, ky ligj ekskluzivisht bëhet për licenca edhe ky ligj, edhe njëherë po ju them, deputetë të nderuar

të Kuvendit të Kosovës, e fyen edhe veten edhe popullin e Kosovës, na fytet intelijenca jonë, nëse ligjet e këtilla kalojnë në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar, Koalicioni Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani,

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje, për zëvendëskryeministrat dhe ministrat që janë prezentë,

Përshëndetje për të gjithë deputetët,

Duke e marrë parasysh, se deri më tani Kosova ka pasur një ligj për aktivitetin me tregti të jashtme të miratuar, në vitin 2002 atëherë, është paraparë nevojë që të ridraftohet dhe të vjen një ligj tjetër apo një ligj, i cili duhet të jetë më i plotësuar për tregti me jashtë.

Pak kohë më parë, ky Kuvend miratoi edhe Ligjin për tregti të brendshme, ku ka qenë një lidhje shumë e ngushtë mes atij ligji dhe këtij ligji dhe nëse duhet të cekem të gjitha kritikën për atë ligj dhe për këtë ligj, atëherë është dashtë që në fillim këto dy ligje të bashkëngjiten. Koalicioni për Kosovën e Re, ka shqyrtuar Projektligjin për Tregti të Jashtme dhe ky projektligj mund t'i ofrohet rregullave për marrëveshjen me OBT-në, apo më mirë të themi për futjen e Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe parasheh një rregullim të fushës së tregtisë së mallrave dhe transaksioneve të pagesave.

Ministria e Tregtisë, me këtë ligj paraqet anën ligjore, në të cilën përcakton rregullat e përgjithshme, mirëpo njëkohësisht përcakton rregullat e importit dhe eksportit të mallrave që bëhen në pajtim me rregullat e OBT-së.

Për zbatimin e këtij ligji, të cilin duhet të ketë Kosova, duhet të ketë bashkëpunim të mirë nëpërmes: Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë Punëve të Punëve të Jashtme, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë të Doganave. Duke e parë rëndësinë këtij ligji që është i lidhur me shumë ministri të tjera dhe për një vendim në të cilin mund të merr Qeveria e Kosovës përmasa reciproke me shtetet e rajonit, atëherë duhet të ceket mjaftë mirë në projektligj, se Qeveria merr vendimin dhe jo vetëm një... një ministri adekuate paraqet ndoshta një vendim, por në total Qeveria merr vendimin, a duhet të paraqiten masat e reciprocitetit?

Në parim, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, do të jep përkrahjen për këtë projektligj, mirëpo të gjitha sugjerimet që u dhanë në seancë, duhet të implementohen që ky ligj në total, të jetë ligj i mirë që i duhet Kosovës në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputetja Biserka Kostić,

BISERKA KOSTIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući,

Parlamentarna grupa Liberalne Stranke, razmotrila je nacrt zakona o spoljnoj trgovini i podržaće nacrt zakona u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje,

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Ovim zakonor se utvrđuju opšta pravila za obavljanje spoljne trgovine, postupci i kriterijumi za uvoz i izvoz tranzit robe, usluge i kapitalne imovine, u skladu sa pravilima Svetske Trgovinske Organizacije i zakonodavstvom Evropske Unije. Ovaj zakon je potez kosovskih institucija da usklade domate zakonodavstvo sa ustavnim propisima, koji važe za Evropku Uniju, Parlamentarna Grupa “6+” smatra zakon vrlo bitnim, podržace i doprinos dat će kroz rad u komisiji, koja je zaduzena za njegovo finaliziranje. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetë të tjerë, s’ka të paraqitur,

Përfaqësuesi i Qeverisë, zoti Zëvendëskryeministër e dëshironi fjalën ?

Zoti Kuqi... ok.

Në vazhdim po ju futemi procedurës së votimit. Në mbledhje të pranishëm janë, 70 deputetë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Faleminderit! Konstatohet se: me 38 vota “për”, asnjë abstenim, 29 vota “kundër”. Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Tregti me Jashtë.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojmë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime dhe ju kisha lutur që në kohën e votimit të mos e lëshoni sallën për kafe, mundësisht!

Vazhdojmë me pikën e 7 të rendit të ditës, që është shqyrtimi i Projektligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare. Në bazë të nenit 56, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit, ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj, Ministrin e Punëve të Jashtme, zoti Enver Hoxhaj!

Që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Hoxhaj, e keni fjalën.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti Kryesues!

I nderuar, zoti Kryesues,

Të nderuar, zëvendëskryeministra, ministra,

Shumë të respektuar, deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Kam kënaqësinë që sot ta paraqes para jush dhe të kërkojmë mbështetjen e juaj dhe miratimin e juaj, për një projektligj shumë të rëndësishëm që e rregullon fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, është fjala për Projektligjin për

Marrëveshjet Ndërkombëtare. Më lejoni që në tri... përmes tri arsyeve ta prezantojë edhe shkurtë këtë ligj.

Së pari, ky ligj e konsolidon dhe e rregullon bazën ligjore, të rregullimit sa më të plotë, sa më të mirë dhe sa më efikas të politikës së marrëdhënieve në mes dy apo shumëpalësh, përmes marrëveshjeve ndërkombëtare.

Së dyti, ky projektligj është edhe një kërkesë e veçantë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila në nenin 18, në paragrafin 5, kërkon rregullimin e parimeve dhe të procedurave për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me një ligj të veçantë.

Së treti, Projektligji për Marrëveshje Ndërkombëtare ka këtë qëllim:

- Përcakton procedurat e negocimit, të nënshkrimit, të ratifikimit, të rezervave dhe të deklaratave, ndryshimit dhe të plotësimit të tërheqjes, si dhe të zbatimit të marrëveshjen ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, pavarësisht se cili institucion ose zyrtar ka lidhur ose nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare në emër të shtetit apo të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Meqë, Kushtetua e Republikës së Kosovës, Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ligji për Shërbimin diplomatik të Republikës së Kosovës, nuk i rregullon në tërësi këto parime, këto procedura të lidhjes dhe të zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, ky ligj është një mekanizëm gjithëpërfshirës dhe i domosdoshëm i rregullimit të çështjeve në fjalë.

Dua të ju informoj që për hartimin e këtij ligji, është punuar intensivisht gjatë vitit, 2008, 2009 dhe 2010. Kanë dhënë një kontribut shumë të madh, shumë misione diplomatike, shumë ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë, si dhe ju jam mirënjohës dhe dua ta ftoj Kuvendin e Kosovës, dua t'ju ftoj gjithë juve, deputetë të nderuar që përmes debateve, përmes sugjerimeve konkrete ta plotësoni këtë ligj dhe ta miratoni në leximin e parë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani, fjalën e kanë deputetët, do të thotë, hapi debatin.

Fjalën e ka, kryetari i Komisionit Funkcional për Punë të Jashtme, deputeti Kurti, në qoftë se dëshiron fjalën.

ALBIN KURTI: Deputet të Kuvendit të Kosovës, Projektligji për marrëveshjet ndërkombëtare ka për qëllim krijimin e një baze ligjore mbi marrëveshjet ndërkombëtare, duke filluar nga procedura e lidhjes e deri tek zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare. Komisioni ynë, e ka shqyrtuar projektligjin n'parim dhe ka rekomanduar që ky projektligj të miratohet n'parim, duke konsideruar që një ligj i këtillë është shumë i nevojshëm dhe se projektligji i propozuar e ka përmbushur n'parim qëllimin e hartimit të tij.

Megjithatë, ky projektligj ka mangësi edhe defekte të shumta, të cilat gjatë procedurës së shqyrtimit në komision, n'cilësitë e Komisionit Funkcional, ne do ta japim kontributin

tonë duke amadamentuar aty ku do të jetë e nevojshme dhe në afatin e duhur kohor, do ta procedojmë projektligjin për miratim në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani fjalën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit të grupeve politike, grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputeti, Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Por Kryesues.... Të nderuar, zëvendëskryeministër, ministra
Të nderuar, deputetë

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike, ka shqyrtuar dhe ka analizuar Projektligjin për marrëveshje ndërkombëtare dhe është dakorduar që të kalohet në parim, në leximin e parë ky ligj me vërejtjet që mund të rrjedhin gjatë miratimit final. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën

SABRI HAMITI: Zoti Kryesues!

Zotni ministra, kolegë deputetë,

LDK përkrahë miratimin në parim Projektligjet për marrëveshjet ndërkombëtare. Ligji është i domosdoshëm, në mënyrë që të mos kemi ligj të veçantë për secilën marrëveshje ndërkombëtare, siç ka qenë rasti deri më tash. Ligji përcakton:

- Natyrën e përgjegjësive të institucioneve, hartimin standard të marrëveshjeve dhe gjuhët e shkrimit të tyre shqip, serbisht dhe një gjuhë e tretë e kërkuar.
- Specifikon detyrat e përgjegjësit e Presidentit, Kuvendit, Qeverisë dhe të Ministrit të Jashtëm, si dhe
- Autorizimet e përfaqësuesve të Republikës së Kosovës në botën e jashtme.

Këtu, meqë jemi në Kuvend dhe është mirë të theksohet për ne, neni fundamental është neni 11, ratifikimi i marrëveshje ndërkombëtare, sidomos paragrafi 1 dhe unë duhet ta lexojë: “Marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me fushat në vijim, i nënshtrohet ratifikimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. E këtu është, neni 1: territori, paqja, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake

1.2. Të drejtat dhe liritë fundamentale

1.3. Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare,

1.4. Marrja e obligimeve financiare nga Republika e Kosovës.

Ky nen është fundamental dhe ju po shihni, këto janë marrëveshje që prekun interesat themelore fundamentale të shtetit të Kosovës, prandaj asnjë nga këto marrëveshje nuk është e vlefshme pa u ratifikuar në Kuvend me 2/3.

Por, lidhur me këtë nen është po ashtu neni 19-të, i cili përcakton kushtet kur tërhiqet vendi ynë nga një marrëveshje e nënshkruar ndërkombëtare.

Sërish e kemi veprimin invers d.m.th. meqë ka të bëjë me të gjitha këto pika që i lexova, kërkojë që neni 19, ku thuhet që Kuvendi prapë voton, të precizohet në 2/3, sepse janë të njëjtat probleme d.m.th te neni 19, pika 2, duhet të thuhet, atje ku thuhet: merret vendimi për ndërprerjen e marrëveshjes ndërkombëtare me 2/3, e Kuvendit të Republikës së

Kosovës. Dhe, kur jemi këtu, unë duhet të ritheksojë dhe jo paqëllim edhe dy përkufizime që janë te neni 316 edhe te neni 317 dhe po i them këtu, sepse janë aktuale: Marrëveshjet ndërkombëtare janë, marrëveshje të cilat nënshkruhen në formë të shkruar dhe kanë kryesisht karakter politik. Dhe, neni 317, marrëveshjet për bashkëpunim ndër institucional, nuk bëhen në emër të Republikës së Kosovës dhe nuk janë subjekt i ratifikimit dhe këto marrëveshje kanë karakter teknik.

Ne jemi në lojën e deklarimeve të marrëveshje ndërkombëtare të Kosovës, në dialogun që po zhvillohet, Kosovë-Serbi, ose si po i thonë Prishtinë-Beograd. Atëherë, në bazë të këtyre përkufizimeve që unë i cilësoj shumë të mira këtu, le t'i shohin edhe zoti ministër i jashtëm, këtu, unë të përgëzoj për këtë mënyrë të hartimit, por po thotë: funksionalisht edhe deputetët le t'i shohin, çka është ndërkombëtare, qysh shkruhet, qysh nënshkruhet, qysh ratifikohet, çka është ndër-institucionale që është teknike as nënshkruhet, as ratifikohet. Faleminderit! Do ta votojmë.

KRYESUSI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, nuk ka të paraqitur... shtype atë Albin. Deputeti Kurti e ka fjalën!

ALBIN KURTI: Së pari, qysh në titullin e ligjit e kemi një si, le të themi, dilemë terminologjike, të quhen marrëveshje ndërkombëtare si nocion që përfshinte gjitha llojet e marrëveshjeve që një shtet i lidh me një shtet tjetër apo organizatë ndërkombëtare, apo të quhen “traktat ndërkombëtar” si term diplomatik, përgjithësisht i pranuar në teorinë dhe praktikën ndërkombëtare, për marrëveshjet ndërmjet shteteve dhe midis shteteve dhe organizatave ndërkombëtare.

Mendoj që kjo dilemë është e qëndrueshme për dy arsye. E para, sepse edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përdoren që të dyja këto terme, kështu fillimisht në nenin 18, përdoret termi “marrëveshje ndërkombëtare” kurse, më vonë në nenin 65, pika 4 përdoret termi “traktat ndërkombëtar”.

Dhe, së dyti kjo dilemë del edhe nga leximi i dy dokumenteve, projektligji dhe memorandumit shpjegues që përdorin të dyja këto terme. Kështu, drafti i këtij ligji përdor termin “marrëveshje ndërkombëtare”.

Ndërkaq, memorandumit shpjegues i po këtij ligji përdor termin “traktat”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në tekstin në gjuhën shqipe, në nenin 92, pika E, përdor termin “marrëveshje ndërkombëtare”.

Bile edhe Maqedonia njësoj, në nenin 28, në tekstin në gjuhën angleze quan “marrëveshje ndërkombëtare”. Dhe, mendoj që sidomos për shkak se kështu e përdor Republika e Shqipërisë dhe besoj që është më e drejtë, është më mirë t'i përmbahemi këtij formulimi të “marrëveshje ndërkombëtare” sesa “traktat”. Por, përndryshe do të duhej definohet qartë, të përkufizohet se çka nënkuptohet me secilën, për ta legjitimuar përdorimin e secilës. Prandaj, sugjeroj që fillimisht të qartësohet dhe të arrihet pajtimi për një term unik, për nocionin themelor, i cili është edhe objekt i këtij ligji, pra marrëveshja apo traktat ndërkombëtar dhe mbi bazën e kësaj pastaj të harmonizohet teksti i projektligjit me tekstin e memorandumit.

Sepse, si në Projektligjin për marrëveshje ndërkombëtare, po ashtu edhe në memorandum shpjegues pra, jo vetëm që përdoren paralelisht këto dy terme, “marrëveshje ndërkombëtare” dhe “traktate ndërkombëtare” por, siç shihet edhe në nenet e më pastajme, edhe brenda të njëjtit nen përdoren që të dy termen njëkohësisht, kjo është e palejueshme në nomo-teknik, pra është e palejueshme në teknikën e shkruarjes së normave juridike.

Në fillim thuhet që Republika e Kosovës, Kuvendi, në bazë të nenit 65, pika e 1-rë, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miraton këtë ligjin. Mendoj që përpos paragrafit 1, duhet t’i referohemi dhe të shtohet paragrafi tjetër 4, pra neni 65, edhe pika 4, ku Kuvendi e ratifikon traktatet ndërkombëtare, pra të mos bazohet kjo vetëm në nenin 65, pika 1 të Kushtetutës, por edhe në nenin 65, pika 4.

Mendoj që neni 1, i projektligjit ka nevojë të amadamentohet, sepse i përshkruan të gjitha fazat e procedurës për arritjen e një marrëveshje ndërkombëtare, përderisa qartë dhe shkurtë do të mund të riformulohej, por këtë sigurisht do të mund ta bëjmë në komisionin tonë që është funksional, në vijim.

Mandej, në nenin 3, tek përkufizimet. Kemi përkufizime, të cilat janë veç të definuara më parë me ligjet e tjera bazike, ndërsa mungojnë përkufizimet e domosdoshme për këtë ligj, si janë për marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe, marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe, etj.

Në nenin 4, e drejta e nismës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, duhet të qartësohet më mirë, sepse kështu siç është ky nen krijohet konfuzion. Së pari, përcaktohet se, e drejta e nismës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare i takon Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, pra në pikën e pare, kurse në paragrafët në vijim, prej 2 deri në 5, edhe subjekteve të tjera, si: ministrive apo autoriteteve përkatëse.

Pa një saktësim më të qartë, kur, ku dhe në cilat kushte, me çfarë procedure edhe këto ministri, autoritetet tjera përkatëse kanë të drejtën e nismës, nesër në praktikë shumë kollaj do të ketë përplasje të kompetencave.

Në nenin 5, marrje e vendimeve për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare, ka një dallim mes tekstit shqip dhe anglisht, sa i përket gjuhës dhe me këtë rast në shqip është përdorur termi “afati kohor”, përderisa në anglisht është “Expedience” që përkthehet “përshtatshmëri, dobi” i njëjti gabim ose mospërputhje përfshihet edhe në tekstin serbisht në të njëjtin nen, këtu kemi të bëjmë me gabim në përkthim, siç duket në gjuhën shqipe dhe serbe, nga ajo angleze, sepse shprehja “afat kohor” nuk po e ka, nuk po ka kuptim, ndërsa expedience po përputhet me qëllimet që po përshkruhen aty. Ky gabim përsëritet në çdo paragraf të nenit 5, përshtypja ime është që termi në gjuhën shqipe është më teknik, ndërkaj termi në gjuhën angleze është më politik dhe kjo është simptomatike.

Gjithashtu, ky gabim përsëritet edhe në paragrafët 4.3, 7.3 të nenit 8, për dhënien e autorizimit si në shqip po ashtu edhe në serbisht. Më tutje, te neni 6, procedura e shqyrtimit të projekt marrëveshjeve ndërkombëtare, nuk po përmendet fare Kuvendi i

Kosoves si institucion, të cilit i dërgohet projekt marrëveshja për shqyrtim, është mirë të futet edhe Kuvendi aty si institucion i veçantë, e jo të lihet mbasi të nënkuptohet nën shprehjen Agjencitë shtetërore, mendoj që në mënyrë eksplicite duhet t'i referohemi Kuvendit të Kosovës këtu.

Në përgjithësi, ka një si lloj prirje që Kuvendi i Kosovës të përmendet sa më pak dhe të përfshihet sa më pak. Në nenin 9, negociatat për marrëveshjen ndërkombëtare fillohet në paragrafin e parë, menjëherë para fillimit të negociatave, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse propozon përbërjen e delegacioni, etj. Mendoj që para kësaj, do të duhej të që definohet mandati, pra një paragraf hyrës ku do të rregullohej çështja e mandatit për negociata, për të lidhur një marrëveshje ndërkombëtare.

Pra, kush e jep këtë mandat, a duhet ai të verifikohet në Kuvendin e Kosovës, kujt i përgjigjet negociatori gjatë këtyre negociatave, si rregullohet llogari dhënia, etj.

Në nenin 10, Forma dhe Gjuha – mendoj që po ashtu ka gabim gjuhësor në shqip, në vend se të përkthehet në alternatin dhe në letrën e vet, nga anglishtja “In it's on alternate and letter” mendoj që duhet të thuhet në gjuhën e tij përkatëse dhe në gjuhën përkatëse të palës tjetër dhe fjala “letter” e ka po ashtu kuptimin edhe të dokumentit zyrtar, pra mund të përkthehet edhe diçka si në gjuhën përkatëse dhe dokumentin e vet zyrtar, por kjo kështu në alternatin dhe në letrën e vet, unë nuk e konsideroj aspak të saktë dhe mendoj që nuk është e drejtë.

Mendoj që edhe dy çështje të tjera mungojnë, cila është gjuha autentike, a duhet me këtë ligj të përcaktohet se, cila gjuhë e kësaj marrëveshje të nënshkruar është autentike për Republikën e Kosovës? Besoj që për t'i mbrojtur interesat tona natyrisht do të duhej të ishte gjuha jonë zyrtare. Dhe, e dyta është forma përjashtuese e arritjes së marrëveshje ndërkombëtare. Në paragrafët 1 deri 4, të nenit 10, është dhënë mënyra ideale e arritjes së një marrëveshje ndërkombëtar, por çka të bëhet me rastet e jashtëzakonshme apo a ka edhe përjashtime nga këto rregulla të dhëna, në paragrafët 1 dhe 4, të cilat po them e përshkruajnë vetëm një situatë ideale.

Në nenin 11, ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, i gjithë paragrafi i parë në fakt, është përshtet i nenit 18, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Unë po ashtu, konsideroj se pos këtyre 4 rasteve, Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet të ratifikojë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare e sidomos, nga dy fushat e tjera që kanë rëndësi, gjeopolitike dhe gjeoeconomike, si marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e energjisë dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e transportit ndërkombëtar. Pra, përveç atyre: territori, paqja, aleanca, çështjet politike dhe ushtarake, të drejtat dhe liritë fundamentale, anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare dhe marrja e obligimeve financiare nga Republika e Kosovës, duhet doemos të përfshihen edhe çështjet e fushës së energjisë dhe transportit ndërkombëtarë. Sepse, a nuk duhet të pyetet Kuvendi i Kosovës për kyçjen e Kosovës për rrjetin ndërkombëtar transportues, apo nëpër korridoret 8 dhe 10, e të ngjashme, apo ndonjë marrëveshje ndërkombëtare që ka të bëjë, ta zëmë me Ngrohjen Global, si bie fjala, Dokumenti i Kopenhagës 2009, kjo teori, o etj.

Pra, dua të them që zhvillimi i marrëdhënieve ndërkombëtare në dekadën e 1-rë, të shekullit 21, i ka nxjerr energjinë, ekologjinë dhe transportin po aq të rëndësishme gjeopolitikishtë, sa edhe pikat 1 dhe 4, të listuara në fillim të këtij neni e që janë të përshkruara nga neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në nenin 14, projekti standard i tekstit të marrëveshje...

(Ndërhyrje: dhe 1 min. zotit Kurti... Regjia shtojani edhe 1 min, zotit Kurti)

ALBIN KURTI: Pra, te neni 14 projekti standard i tekstit të marrëveshjeve ndërkombëtare, po duket që po anashkalohet edhe njëherë Kuvendi në përpilimin e tekstit standard, edhe pse aty do të përcaktohen disa parime të përgjithshme, prapë se prapë është mirë që ato të kalojnë nëpër Kuvend. Mendoj që të gjitha, këto vërejtje që i thash, në emër të lëvizjes “Vetëvendosje” janë vetëm fillimi i një debati për këtë projektligj, i cili duhet të jetë bazë i një ligji shumë të domosdoshëm, por siç e shpjegova deri më tash, me shumë defekte e mangësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurti!

Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” deputetja Donika Kadaj-Bujupi,

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Okej... më falni

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, i nderuari Kryesues!

Po dokët se jeni lodh n’pozitën që jeni kogja gjatë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, sigurisht që do ta përkrahë këtë ligj, për faktin se... për arsyet se është i domosdoshëm për Kosovën, sidomos në këtë fazë, sidomos për do të thotë, aspektin e procedurave të cilat rregullon, p.sh. negocimin, nënshkrimin, ratifikimin edhe aspektet e tjera, të cilat veçse janë vepruar ditëve të kaluara në Republikën e Kosovës apo ka pasur veprime në këtë drejtim, mirëpo veprime të cilat nuk do të mund të bazohen në këtë ligj, veprimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, siç ishin; negociatat me Serbinë, dialogu apo qysh do që e quajmë dhe të cilat nuk do të mund të bazohen në këtë ligj apo në ligjet e tjera. Prandaj, po na vjen mirë që do të thotë, edhe pse goxha vonë ne e kemi këtë ligj para nesh, i cili do të rregullojë p.sh. në sferën e negociatave, do të rregullojë temat, siç janë: delegacioni, para fillimit jo pas fillimit, qysh na ka ndodh, siç janë: përbërja e delegacionit, afatet kohore, temat, pastaj ratifikimin Kuvend dhe aspektet e tjera, të cilat na kanë munguar.

Konsiderojmë që do të thotë, do të kemi nevojë në komision të punojmë goxha shumë, të japim kontributin tonë. Unë do të jap vetëm disa sugjerime të shkurta, p.sh. tek paragrafi 4 dhe 5, është shumë kundërthënëse, është faqe 17, besoj që do të merrni shënime dhe do të bëni një, të punojmë, të ndërhyrjet, sepse është goxha kundërthënëse dhe jo e saktë.

Gjithashtu, ka edhe elemente të tjera, të cilat lidhen, nuk lidhen njëra me tjetrën dhe janë shumë kundërthënëse, mirëpo ne kërkuam këtu të përkufizimet mos po gjejmë edhe fjalën “konkluzion”, sepse po shihet një tendencë që ligji për shkak të shumë mangësive dhe elementeve të cilat nuk janë futur në të, të i adaptohet veprimeve të deri tanishme të Qeverisë dhe jo të ndodh e kundërta. Kjo është edhe, si duket arsyeja se, pse ka mangësi të shumta të sferave, të cilat janë të diskutuara më parë, të cilat janë thënë që nuk janë marrëveshje, janë teknike, por që në fakt, janë shumë politike dhe duhet të kenë një bazë ligjore. Prandaj, konsiderojmë që në komisionin, do të thotë, prej leximit të parë deri në leximin e dytë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, do të japë kontributin e vet që këto mangësi të shtohen, të i shtohen ligjit, sepse në fund të fundit duhet të mësohemi që ligjet nuk bëhen për Qeverinë aktuale, por duhet të bëhen për të mirën e vendit dhe duhet të jenë të zbatueshme dhe duhet të rregullojnë sferat të cilat do të lidhen me përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Prandaj, duke do të thotë, votuar në parim, në komisionin përkatës do të punojmë goxha shumë që vërejtjet të cilat i dhanë edhe grupet tjera parlamentare, por edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, t’i përmirësojmë dhe të sjellim një ligj të mirëfilltë, sepse është shumë i domosdoshëm për Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Novobërdaliu!

SUZANA NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar Projektligjin për marrëveshjet ndërkombëtare. Deri më tani, këtë projektligj nuk e kemi pas dhe këto çështje janë rregulluar vetëm me Kushtetutë edhe në Kushtetutë i kemi disa konfuzitete, të cilat duhet të sqarohet nga komisioni, prandaj konsiderojmë që një ligj të domosdoshëm dhe të njëjtin e përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Saša Milosavljević

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući, Parlamentarna grupa Samostalne Liberalne Stranke je razmatrala nacrt zakona o međunarodnim sporazumima i mi ćemo u načelu podržati ovaj zakon.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Komitetit “6+”, Rasim Demiri!

RASIM DEMIRI: Hvala, predsjedavajući!

Pročitati Hvala predsjedavajući. Pročitati smo izvršili analizu ovog N/z, smatramo da je neophodno da se donose jedan ovakav Zakon, odnosno da se formira kosovska akademija za bezbednost i za razloga što će ista izvršiti usluge, provoditi i unaprediti savremena naučna dostignuća koja se tiču rada policije, carine popravne službe i tako dalje. Dakle stvoriće se jedan centar znanja kojim će se koristiti velikim broj državnih institucija. Parlamentarna grupa 6+ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti, Hydajet Hyseni, e ka kërkuar fjalën,

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja, zotërinj deputetë,

Nuk do ta merrja fjalën pas asaj që u tha edhe për shkak të disponimit që në fillim, pak merret me mend, nuk është edhe aq për t'i zgjat, si thuhet diskutimet e për krejt taravi, por e konsideroj të nevojshme që të theksoj disa çështje që lidhen me këtë ligj.

Së pari, e përsëritës sjelljen në Kuvend të këtij ligji. Konsideroj se i duhet Kosovës një ligj i tillë dhe i duhet jo vetëm pse mungon ky ligj, por sepse as Kushtetuta nuk është e qartë në këtë fushë dhe këtu dua të vë theksin. Është një kontekst krejt i pazakonshëm Kushtetuese ligjore që ka prodhuar një konfuzion edhe në praktikë, në ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe procedurën që i paraprinë asaj. Për më tepër, ligji, mendoj se nuk ka arrit aq që ka mund t'i zhदारarit mjegullinë që ka krijuar Kushtetuta. Pjesërisht ka mbetur rob i formulës Kushtetuese, ka bërë përpjeke të dalë aty ku ka qenë e bindur se nuk është në rregull, por mendoj se, megjithatë me kufizimet që janë vënë, e ka bërë të zorshme që ta rregullojë me ligj fushën që...

Që në titull, ka një mospërputhje, në anglisht është “ Treaty”, në shqip është për “marrëveshjeve ndërkombëtare”, por në shkresën përcjellëse është thënë se: marrëveshje tjera janë eliminuar nga ky ligj, dhe këtu tash fijohet një dilemë shumë serioze.

Së pari, mospërputhja midis versioneve në gjuhë të ndryshme, e dyta, çështja çka po vendosim ne? Mos të harrojmë kemi një ligj për marrëveshjet financiare, do të bëjmë ne ligje për marrëveshje kulturore të veçantë, një ligj për marrëveshje sportive të veçantë, për fusha të ndryshme apo do të ketë një ligj bazë që rregullon gjitha marrëveshjet. Ky është edhe sugjerimi im, të cilin e konsideroj të nevojshme ta shtroj që në diskutim, në parim. Në Shqipëri, ta zëmë është Ligj për marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare, pse të mos jetë edhe këtu? Traktatet janë një lloj marrëveshje, por meqë janë të veçanta ka kuptim edhe të veçohen, por nuk mund të jetë në një gjuhë ndryshe dhe në një gjuhë tjetër, po e injoroj ato që në shkresën përcjellëse janë thënë edhe gjen një gjuhë vërtetë e pazakonshme sikur kjo, ta zëmë, arsyeja për hartimin e këtij ligji janë arsyet e mëposhtme, etj. ligji nuk duron gjuhë të tillë. Për më tepër edhe në zbatimin e ligjit, në përmbajtjen e ligjit. Në një vend thuhet: ligji rregullon zbatimin e ligjit, e çështjes së marrëveshjes, më falni për pasaktësinë edhe timen, por në pjesë të tjera thuhet: rregullon edhe çështjen e të drejtave dhe kompetencave për të nënshkruar marrëveshjen ndërkombëtare. Së pari, kjo është interferim çështjet që janë Kushtetuese, për më tepër ne Kushtetutën nuk e kemi në rregull dhe jemi në proces të ndryshimit, pikërisht edhe në këto çështje dhe mendoj që kjo imponon nevojën e harmonizimit të gjithë procesit edhe me ndryshimet Kushtetuese që po bëhen edhe me Ligjet për financat dhe mendoj që mund të rregullohet, duke qenë një ligj gjithëpërfshirës dhe pastaj, çështjet tjera mund të rregullohen edhe me akte të veçanta.

Është interesant në Grupin Punues që ka punuar në këtë ligj, gjithë përfaqësuesit e subjekteve, institucioneve tjera, përmenden me emër, por thuhet përfaqësuesi i Kuvendit dhe aty s'ka emër fare. Unë nuk e di, a ka pasur Kuvendi një përfaqësues në Grupin Punues, apo jo?

Një fenomen që për mendimin tim, nuk duhet të kalojë pa u theksuar edhe në këtë shqyrtim të parë është fakti që nuk janë sqaruar raportet midis institucioneve. Presidenti te ne vazhdon të trajtohet sipas dy modeleve, edhe sipas modeleve ku ajo është, si të thuash, “alternative” ose “zëvendësimi i mbretit” si superstituti, por edhe në vendet, sipas vendeve ku ajo është ekzekutiv që është një substitut dhe në raste të tilla, ai mund edhe të bëjë marrëveshje teknike, për të cilat s’ka nevojë të ratifikohen, por nuk mund të jenë të dyja, në praktikën tonë janë të dyjat, për fat të keq as ligji këtë çështje nuk e ka rregulluar dhe shtrohet pyetja natyrshëm: ku është këtu, Ministria e Punëve të Jashtme? Në gjitha vendet Ministria e Punëve të Jashtme ka një rol, më me peshë, është çështja që ajo e rregullon dhe po të lejohet praktika që është paraparë me ligj që pothuajse, gjitha nismat të autorizohen paraprakisht nga presidenti, druaj që i lidhin duart ministrisë për të bërë punën, për të cilat ajo është edhe e thirrur, natyrshëm është kompetent, mendoj që praktikat e vendeve tjera janë të dobishme.

Po ashtu, nuk më duket në rregull ndoshta që edhe në çështjen e tërheqjes së marrëveshjes, vetë shprehja “ tërheqje” s’më duket adekuate, vendet tjera e kanë përdorur në gjuhën shqipe “denoncim” i marrëveshjeve ndërkombëtare kështu është edhe në anglisht edhe në ligjin dhe mendoj që nuk ka të keqe të përdoret një gjuhë edhe qoftë edhe në shprehje të huaj, por që është e integruar në fjalorin shqip, por çështja dhe më e rëndësishme sesa vetë terminologjia është procedura, denoncimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Nuk mund të pajtohem në praktikën që kjo të bëhet, si thuhet atje: me nënshkrim të presidentit ose etj, etj. çështje shumë të rëndësishme dhe pajtohem me parafolësin që thotë, se: për çështje tilla duhet e njëjta kompetencë dhe duhet angazhim i duhur i Kuvendit të Kosovës, si organi më i lartë i pushtetit.

Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare është përgjegjësi e organit më të lartë pushtetit. Në Kosovë është dhe duhet të jetë edhe në të ardhmen Kuvendi- Organi më i lartë i pushtetit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur, zoti ministër dëshironi fjalën përfundimtare, zoti Hoxhaj e ka fjalën!

ENVER HOXHAI- Faleminderit, zoti Kryesues!

Shumë të respektuar, deputetë,

Unë me vëmendje i dëgjova të gjitha sugjerimet, propozimet dhe debatin që e patëm këtu, mora edhe personalisht shënime për çdo propozim që ju dhatë deri më tash, në të njëjtën kohë do ta marrim edhe transkriptin e kësaj seance dhe do ta shqyrtojmë çdo sugjerim që ju e keni dhënë dhe besoj që në Komisionin për politikë të jashtme, si ministri e Punëve të Jashtme, do të bëjmë përpjekje që për të gjitha dilemat, sfidat, sugjerimet dhe propozimet që i patët, **dalim** edhe me propozime konkrete. Ju jam shumë mirënjohës, për propozimet që i kishit dhe besoj që gjatë muajve në vijim do të jem në gjendje që ta përfundojmë një ligj të tillë, i cili është shumë ma i rëndësishëm sesa vetëm aspekti kohor, i viti 2011. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Tani futemi në fazën e votimit të ligjit, në mbledhje janë të pranishëm 80 deputetë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Nait a don me votu?

(Ndërhyrje: dëgjohen të qeshura)

KRYESUESI: Faleminderit!

Konstatojë se me : 75 vota “për”, asnjë abstenim, asnjë “kundër”

Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për marrëveshje ndërkombëtare. Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë, me rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e 8, të rendit të ditës që është: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akademinë e Kosovës për siguri publike.

Në bazë të nenit 56, të rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime. Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepin që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

BAJRAM REXHEPI- I nderuari, kryesues i Kuvendit,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantojë para jush Projektligjin për Akademinë e Kosovës për siguri publike, i sponzoruar nga ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për Akademinë e Kosovës për siguri publike është hartuar duke u bazuar në strategjinë legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për vitin 2011 dhe në pajtim të plotë me rregulloren e punës së Qeverisë, numër 1/2007. Qëllimi i këtij ligji është, themelimi i Akademisë së Kosovës për siguri publike. Arsyeja për hartimin e këtij projektligji qëndron në faktin se, aktualisht në Republikën e Kosovës, Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim, është mbi bazën ligjore të UNMIK-ut, gjegjësisht rregullorja numër 2008/18.

Për themelimin e bordit mbi standardet e sigurisë publike dhe arsim, si dhe urdhëresën administrative numër 2008/3.

Për ta avancuar procesin e funksionimit të kësaj qendre, ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës për siguri publike, edukim dhe zhvillim, ka hartuar projektligjin i cili rregullon fushëveprimin e kësaj qendre. Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim, si agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të ministrisë së Punëve të Brendshme, është një institucion i cili ofron trajnime dhe arsimin e lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë, si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Për të gjitha institucionet e sigurisë publike, gjatë punës së hartimit të projektligjit dhe me pajtimin e të gjithëve Grupit Punues, qeveritar dhe konsultimeve me mekanizmat përkatës është ndërruar edhe emërtimi i qendrës së Kosovës për siguri publike, edukim dhe zhvillim në emërtimin e ri Akademia e Kosovës për siguri publike.

Kjo ka rezultuar edhe me ndërrimin e emërtimit të projektligjit, i cili fillimisht ka qenë i parashikuar si Projektligj për Qendrën Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim dhe nga Grupi Punues qeveritar, ka dalë me emërtimin Projektligji për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Kjo është bërë në mënyrë që kjo akademi në të ardhmen e afërt, të përfshijë të gjitha kërkesat dhe synimet e institucioneve të sigurisë publike të Kosovës si dhe Akademia t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, për të ofruar shërbimet e edukimit të lartë për sigurinë publike. Fakt ky që e vështirëson procesin e akreditimit pa një bazë të mirëfilltë ligjore. Projektligji për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike është i harmonizuar me Kushtetutën dhe instrumentet ligjore, të cilat janë pjesë direkte e zbatimit, në Republikën e Kosovës dhe si e tillë është përshtatur rrethanave të reja të krijuara në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj përmban gjithsej 9 kre dhe gjithsej 22 nene, duke filluar nga dispozitat e përgjithshme, dispozitat shpjeguese, si dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare. Hartimi i projektligjit është bërë në pajtim me procedurat e parapara dhe për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat respektive nga ministria e Financave dhe ministria e Integrimit Evropianë, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me ... Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

E hapi debatin, fjalën e ka kryetari i Komisionit për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrje të forcës së sigurisë, deputeti Ahmet Isufi, Atëherë, në vend të tij, deputeti Rexhep Selimi!

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt Komisioni për shqyrtim... Komisioni pas shqyrtimit në parim, të Projektligjit për Akademinë e Kosovës për siguri, ka versuar se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit, miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Përfaqësues të grupeve parlamentare, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputetja Vjollca... jo, jo, deputeti Fatmir Xhelili!

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryesues!

Përsëritet për kabinetin, për të nderuarit deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe e përkrahë në parim, për at arsye se, mundësohet themelimi i një akademie e cila do të ngrisë cilësinë dhe funksionalitetin e kësaj qendre që deri tash ka qenë Qendra për Zhvillim dhe Edukim të sigurisë publike dhe besoj që me këtë mundësohet standardizimi dhe ngritja e cilësisë të arsimit të kuadrove për zyrtarë policor, zyrtar doganor, për zyrtar korrektues, zjarrfikësat etj. dhe mundëson ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë në fushëlaminë dhe në rrafshin e sigurisë.

Ky ligj është n'përputhje me ligjet tjera ekzistuese të Kodit Penal, Kodit të procedurës Penale, të Ligjit të policisë, Ligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera që edhe Ligjin për zjarrëfikëje, kështu që besoj që do të ndikojë në rritjen e cilësisë në këtë fushëlamë dhe besoj që kontributin e mëtejshëm do ta japim në ngritjen e cilësisë të këtij projektligji edhe gjatë punës në komisionin tonë parlamentar.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentarë "Vetëvendosje" kush... a! LDK-ja, m'fal, LDK është Vjollca Krasniqi, deputetja Krasniqi!

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar Projektligjin për Akademinë e Kosovës për siguri publike.

Kjo materie trajtohet gjithsejtë me 22 nene, të cilat në përgjithësi nuk precizojnë minimumin e kërkuar si garancë që ligji të jetë i implementueshëm dhe funksional. Disa nga çështjet që nuk trajtohen fare apo trajtohen në mënyrë sipërfaqësore janë:

- Përzgjedhja apo emërimi i drejtorit të përgjithshëm të Akademisë,
- Strukturën organizative të Akademisë,
- Drejtorinë,
- Stafin e përgjithshëm,
- Stafet e shkollave dhe specializimeve,
- Trupin për standardizime, hulumtime dhe doktrina,
- Mbështetjen apo logjistikën

Nuk precizon në mënyrë të saktë se, cilat lloj të trajnimeve mund t'i ofrojë kjo akademi, cilat lloje të shkollave apo specializimeve ofron, ato bazike, individuale, kolektive, të avancuara apo specialistike.

Nuk precizon në mënyrë të saktë, mënyrën e përzgjedhjes së personelit në përgjithësi, udhëheqësit e trajnimeve dhe shkollave, ligjëruesit, instruktorët, ekspertët etj. Mënyrën e vlerësimit të kadetëve, studentëve apo vijuesve të trajnimeve apo shkollave, si: selektimin e kandidatëve, kohëzgjatjen e trajnimeve, programet, notimin, masat simulative dhe ndëshkuese.

Nuk precizon ndër lidhshmërinë e rezultateve nga ky shkollim apo trajnim me përparimin në karrierë.

Nuk përcakton kushte adekuate apo të veçanta për gjininë femërore, meqenëse kemi të bëjmë me siguri publike.

Nuk përcakton sigurinë në punë dhe gjatë trajnimit apo shkollimit.

Nuk përcaktohet qartë se, kjo Akademi do të jetë organizëm i ri në kuadër të ministrisë së Punëve të Brendshme, apo do të jetë trashëguese e Qendrës Kosovare për siguri publike me staf dhe pasuri të sajën. E dimë dhe jemi të vetëdijshëm që është e nevojshme të kemi një Projektligj për këtë Akademi, mirëpo si Lidhje Demokratike e Kosovës, gjegjësisht si Grup Parlamentar, konkludojmë dhe mendojmë që ky projektligj të kthehet edhe njëherë në ministrinë për Punë të Brendshme dhe Grupi Punues t'i bëjë një trajtim më profesional, të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Rexhep Selimi!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt, me këtë ligj pavarësisht mangësisë së saj që po themelohet Akademia e Kosovës për Siguri Publike. Fakt ndoshta i mjaftueshëm për ta mbështetur këtë ligj dhe për të dhënë kontributin tonë, në plotësimin e gjithçka që ne e konsiderojmë si zbrazëtirë në këtë ligj.

Gjithsesi, ky ligj është një ligj bazik që ka nevojë për shumë plotësime, sidomos në esencë. Po ashtu, në këtë ligj ka nevojë, për plotësime edhe të neneve të veçanta dhe njëri ndër nenet të cilit duhet t'i shtohet këtij ligji, është neni për bashkëpunim ndërkombëtar që faktikisht i mungon këtij ligji dhe besoj që në Komisionin parlamentar për siguri të Punëve të Brendshme dhe mbikëqyrje të FSK-së, do ta kemi mirëkuptimin e mjaftueshëm për ta shtuar këtë ligj.

Ne si Grup Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” jemi të fokusuar që të japim kontributin tonë, por kryesisht në disa nene, siç është: neni 6, pika 1, në lidhje me udhëheqjen e Akademisë, pra të saktësohen procedurat e emërimit të drejtorit, mendoj që ka nevojë të saktësohet më shumë dhe të plotësohet. Pastaj, jemi të fokusuar edhe në nenin 9, i cili ka të bëjë me buxhetin e Akademisë, ku formulimi i përgjithshëm në këtë projektligj krijon zbrazëtirë juridike, sa i përket buxhetit të Akademisë. Pastaj, po ashtu edhe në nenin 17, të përcaktohet më saktësisht roli i bordit të Akademisë që ky bord, të jetë më i fuqishëm dhe më i saktë.

Ne vlerësojmë që Akademia e Kosovës për Siguri Publike, ka rrethana dhe kushte që të plotësojë me kapacitete profesionale dhe infrastrukturore që të bëjë trajnimin e mirëfilltë Policisë së Kosovës, shërbimit korrektues, shërbimit sprovues, doganën e Kosovës, Agjencinë e menaxhimit emergjentë, inspektoratin policor të Kosovës dhe si të tillë ne, si ligj jo vetëm që do ta përkrahim me rezervat tona, por do të japim kontributin tonë, në komisionin funksional. Në cilësinë e udhëheqjes të këtij Grupi Punues për këtë projektligj, unë do të përpiqen bashkë me bashkëpunëtorët e mi, t'i përfshijë të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet të dala nga deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe nga çdo lloj grupi interesit, duke qenë të sigurt dhe të bindur që ne do t' arrijmë që në leximin e dytë t'ia sjellim Kuvendit të Kosovës, një ligj shumë të nevojshme për Akademinë e Kosovës për siguri publike.

Si të tillë, ne e përkrahim në parim dhe do ta votojmë në leximin e parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ahmet Isufi!

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ky projektligj është i mirëseardhur, edhe pse është dashur të draftohet shumë më herët, për arsye të nevojave që ka pas Kosova, për një ligj të tillë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim duke e pasur edhe vërejtjet e veta në segmente të caktuara dhe nene të cilat kanë bëjnë me, përmirësimin e këtij draft ligji.

Koncepti i trajnimit të institucioneve përgjegjëse, për rend dhe qetësi publike në Kosovë, është një koncept i ri dhe mund të them lirisht që është një koncept i mirë dhe vendet fqinje, kanë filluar ta adaptojnë konceptet, duke u bazuar në këtë koncept. Në përgjithësi mendoj se, projektligji përmbush kërkesat bazike për themelimin, organizimin e kësaj Akademisë, por, megjithatë ka nevojë për plotësime dhe ndryshime në ditët në vijim. Kur them këtë, kam parasysh me sa vijon, ky ligj është shumë gjithëpërfshirës dhe shumë gjëra mbesin të rregulluara me aktet nënligjore.

Duhet të sigurohet se ky ligj, nuk bien ndesh me ligjet që janë në fuqi e që rregullojnë funksionimin në veçanti, trajnimin e institucioneve sigurisë publike që janë pjesë e Akademisë, e që janë të cekura në nenin 3, paragrafi 1.3. Policinë e Kosovës, shërbimin korrektues, shërbimin sporvues, doganën e Kosovës, Agjencinë e menaxhimit emergjentë, Inspektoratin Policor të Kosovës, etj.

Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet pjesës ku, flitet për zhvillimin e kurikulave dhe ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë në fushën e sigurisë publike përmes programeve të akredituara nga ana e autoritetit kombëtar të kualifikimeve, apo Agjencisë Kosovare për akreditim.

Në këtë projektligj nuk kemi hasur në asnjë nen që mbulon bashkëpunimin ndërkombëtar që sipas nesh, është shumë me rëndësi. Gjithashtu, duhet që në ligj të qartësohet edhe më mirë kreu i 8-të, neni 19, trajnimet dhe shërbimet tjera me pagesë që thuhet, po citoj: "Akademia ofron trajnime nga fusha e sigurisë publike dhe shërbimet tjera, me pagesë për persona fizikë dhe juridik". Në paragrafin 2, po ashtu, trajnimet, shërbimet dhe mënyrat e pagesës, sipas paragrafit 1, të këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Akademisë, akt ky që miratohet nga ministri i Punëve të Brendshme. Ky nen, duhet të qartësojë profilin e personave fizik dhe atyre juridik që do të kenë mundësi, të trajnohen me pagesë në këtë qendër. Nuk besoj që duhet të mbetet që të rregullohet me akt nënligjor, sepse mund të ndodhemi para një situatë që kjo Akademi të shndërrohet në një qendër biznesi, gjë të cilën nuk besoj se e dëshirojmë asnjë nga ne.

Pra, duke mos dashur të zgjatëm më shumë dhe duke i përkrahur edhe kolegët që folën më herët, në ndryshimet që do të pësojnë më vonë. Si grup parlamentar e përkrahim ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputeti Gëzim Kelmendi,

Gëzim Kelmendi: Faleminderit!

I nderuari kryesues,
I nderura Kabinet Qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Projektligji për formimin e Akademisë Kosovës për siguri publike, padyshim që është edhe një sprovë për ne, si shtet i ri dhe në periudhë tranzicionit, por për të mos i përmendur dhe përsëritur të njëjtat fjalë të parafolësit, i nderuari, i cekën, kisha me u ndal vetëm te këto tri nene, të cilat kemi vërejt disa mangësi.

Ku te neni 12, shihet qartë se, pagesat për personelin trajnues dhe mësimdhënësit duhet të përcaktohen me akt nënligjor, çka i jep shumë hapësirë dhe pakënaqësi brenda vetë personelit, kështu që do të ishte më e udhës dhe më e mirë që këto paga, të sigurohen në bazë standardit të mësimdhënësve në nivel të Kosovës, apo brenda pjesëtarëve të stafit civil.

Ndërsa, sa i përket nenit 14, te përgjegjësit dhe detyrat e drejtorit përgjithshëm të Akademisë, këtu shihet qartë dhe janë numërua pika mjaftë të qartazi, kompetencat e drejtorit, por shihet tek paragrafi 1.2. i është dhënë edhe kompetenca mjaftë të gjëra në rekrutimin e personelit dhe në vetë organizimin akademisë, në këtë rast me rekrutimin e personelit do të ishte më e udhës dhe më vendimmarrëse se këtë të merret ministria e Punëve të Brendshme dhe jo drejtori i Akademisë. Në anën tjetër, edhe nxjerrja e akteve nënligjore nga ana e drejtorit nuk do të ishte valide dhe mjaftë e fuqishme në krahasim nëse këto akte nënligjore nxirren nga vetë ministria e Punëve të Brendshme dhe jo nga drejtori i përgjithshëm.

Vërejtje tjetër është te neni 19, ku shihet gjithashtu se, trajnimet dhe shërbimet dhe gjitha këto funksione shpërblehen me pagesë, të cilat nxirren me aktet nënligjore nga drejtori i përgjithshëm. Prapë kompetenca edhe për pagesë i jepen drejtorit të përgjithshëm dhe anashkalohet funksioni ekzekutiv, siç është ministria e Punëve të Brendshme. Ne si koalicion për Kosovë të Re, në parim e përkrahim me shpresë që vërejtjet tona do të kenë parasysh Komisioni Funkcional.

KRYESUESI: Faleminderit!
Grupi Parlamentar SLS, deputeti Saša Milosajević,

SAŠA MILOSAJEVIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!
I parlamentarna grupa SLS razmatrala je Nacrt zakona o kosovskoj akademiji za javnu bezbednost i mi ćemo u načelu podržati ovaj N/z uz određene dopune koje ćemo dopuniti kroz funkcionalne Komisije u narednom periodu.

KRYESUESI: Faleminderit!
Grupi Parlamentar “6+”, deputeti Demiri,

RASIM DEMIRI: Hvala predsedavajući!
Pročitali smo izvršili analizu ovog N/z, smatramo da je neophodno da se donose jedan ovakav Zakon, odnosno da se formira kosovska akademija za bezbednost i za razloga što će ista izvršiti usluge, provoditi i unaprediti savremena naučna dostignuća koja se tiču

rada policije, carine popravne službe i tako dalje. Dakle stvori će se jedan centar znanja kojim će se koristiti velikim broj državnih institucija.

Parlamentarna grupa 6+ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani grupet parlamentare janë deklaruar, janë edhe 4 deputetë që kanë diskutime shtesë, deputetja Xhevahire Izmaqu ka kërkuar fjalën,

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Përschendes vendimin e ministrisë së Punëve të Brendshme për të sjell në Kuvend një projektligj të tillë, i cili do t'i ndihmojë Akademisë për një funksionalizim sa më të mirë të punës së vet dhe misionit shumë të madh.

Duke u bazuar edhe faktin se, Qendra e Kosovës për siguri publik, edukim dhe zhvillim, tash me projektligj, Akademia e Kosovës për siguri publike, selinë e saj e ka në Vushtrri, qytet nga i cili vi unë, ka bërë që unë të jem më e interesuar dhe të kem një qasje më aktive rreth këtij projektligji.

Po ashtu, më lejoni që të përschendes vendimin e komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim të pronës së vet, në funksion të ndërtimit të infrastrukturës përcjellje të kësaj Akademie. Gjeneratat e dala, fillimisht nga shkolla e policisë, tani qendra e Kosovës për siguri publike, edukim dhe zhvillim e në të ardhmen Akademia e Kosovës për siguri publike, ka bërë që ne gjithë të mburremi me këta djem e vajza të shtetit tonë.

Ngjarjet e kohëve të fundit në pikën 1 dhe 31, kanë bërë që ne si deputet të shohim rëndësinë e këtyre agjensioneve të sigurisë publike, si dhe arsyeshmërinë për investime sa më të mëdha në këtë fushë, e si pretekst i kësaj, pra mund të jetë edhe ky projektligj që ngërthen në vete trajnimin dhe edukimin e pothuajse të gjitha agjensioneve të sigurisë publike, por duke mos u kufizuar vetëm në: Policinë e Kosovës, shërbimin korrektues, shërbimin sprovues, doganën e Kosovës, Agjencinë e menaxhimit emergjent dhe inspektoratin policor të Kosovës.

Me vëmendje dhe përkushtim, kam lexuar draftin e parë të këtij projektligji që na është prezantuar këtu neve, por kam pak vërejtje, në këtë projektligj po ashtu, të draftuar mirë, mirëpo në disa formulime të fjalive të cilat mund të jenë edhe më mirë, sigurisht që gjatë punës në komision do të rregullohen.

Karakteristikë dhe risi e këtij projektligji, përpos emrit të ndryshuar kemi të bëjmë me kreun e 6-të, të arsimit të lartë për siguri publike në Akademi dhe nenin 16, për faktin se, në periudhën 3 vjeçare në Akademinë e Kosovës për siguri publike, parashihet të ofrohet edhe arsimit të lartë në fushën e sigurisë publike.

Projektligji ka për qëllim të përfshijë të gjitha çështjet, të cilat kanë të bëjnë me Akademinë e Kosovës për siguri publike si të vetmin institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimimit të lartë dhe zbatimin e politikave e strategjive të trajnimit, në këtë fushë.

Së bashku me, një grup deputetësh me datën 5 korrik 2011 kemi vizituar qendrën, ku qëllimi i kësaj vizite ishte informimi më për së afërmi me punën trajnimet, aktivitetet dhe fazat tjera të rëndësishme, të cilat po kalon qendra e sigurisë publike. Në këtë takim me menaxhmentin e qendrës, jemi njoftuar se në, procesin e ngritjes së kapaciteteve dhe angazhimeve të saj në përputhje me obligimet që dalin nga Kushtetuta e Republikës Kosovës, legjislacionit të fuqive, prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ministria e Punëve të Brendshme dhe qendra e Kosovës për siguri publike dhe zhvillim, po vazhdon me reformimin e saj fillimisht duke iniciuar këtë projektligj për qendrën, pastaj duke e zhvilluar planin zhvillimor strategjik, ristrukturimin e brendshëm organizativ të tij dhe aplikimin për akreditim nga autoriteti kombëtar të kualifikimeve, si dhe rialokimin e resurseve të veta, e që pa dyshim që këto veprime do të ndikojnë në përmirësimin e performancës së saj, duke ngritur efikasitetin dhe efektivitetin në punën e vetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Demolli e ka fjalën,

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit, i nderuari zotëri kryesues,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar deputetë të Kuvendit, qe si duket pak sa jeni të lodhur edhe ka filluar pak biseda mes nesh.

Mirëpo, duhet t'i them disa fjalë lidhur me këtë projektligj dhe në përgjithësi, për këtë projektligj mendoj që është mjaftë i zbehët dhe shumë gjithëpërfshirës, sepse nuk rregullon çështje kryesore të cilat duhet të jenë objekt i trajtimit të tij, por zgjedhjet, respektivisht rregullimin e këtyre çështjeve e parasheh me akte të mëvonshme nënligjore që do të aprovohen në të ardhmen si nga ministria ashtu edhe nga Qeveria.

Kështu, për shembull: këto janë çështjet, të cilat kanë mbet të rregullohen me akte nënligjore e që vërtetë, mendoj që duhet të ishin të rregulluara me këtë ligj, si p.sh. zhvillimi, misioni, funksionalizimi i arsimit të lartë në akademi, në këtë Projektligj thuhet, se: do të rregullohet me akte nënligjore.

Më tutje, kur flet për planifikimin e trajnimeve, pastaj kur flet për të drejtën e pagesës dhe shpërblime, pastaj kur flet për strukturën organizative të akademisë, pastaj kur flet për konstituimin e bordit të akademisë, si dhe për kushtet e trajnimit për persona fizik dhe juridik, në të gjitha këto raste thuhet se: do të nxirret një akt nënligjor, me të cilin do të rregullohen këto çështje.

Prandaj, mendoj se shumë më i kompletuar do të ishte ky ligj, sikurse disa prej këtyre çështjeve të rregulloheshin me dispozitat e tij, sesa të mbesin objekti i akteve të ndryshme nënligjore që do të nxirren më vonë.

Si një çështje të dytë, për të cilën dua të diskutoj, tani është neni 2. në të cilën thuhet: Akademia e Kosovës për siguri publike është institucion përgjegjës, për ofrimi ne trajnimeve dhe theksoj arsimit të lartë. Mendoj se, me këtë ligj, kuptohet duke u bazuar

në dispozitat e ligjit mbi arsimin e lartë duhet të saktësohen këto çështje sa i përket ofrimit të arsimit të lartë.

1. Duhet të precizohet se cilat nivele të arsimit të lartë mund të ofrohen në kuadër të kësaj akademie, ndonëse kalimthi përmendet në nenin 16, pika 2, se arsimi i lartë për siguri publike në akademi zhvillohet në pajtim me ligjin për arsimin e lartë, sipas mendimit tim kjo dispozitë nuk është e mjaftueshme. Mirëpo, çka duhet? Duhet që në këtë ligj të precizohen se, cilat janë nivelet e arsimit të lartë që do të afrohen apo që do të ushtrohen në kuadër të kësaj akademie? Duke filluar nga arsimi themelor i lartë, pastaj nga specializimet eventuale, pastaj nga studimet e masterit eventual, si dhe nga studimet e doktoraturës eventuale.
2. Si çështje e dytë, atje përmendet personeli trajnues, ku si personel përmenden mësimdhënësit, shtohet pyetja: Në qoftë se ofrohet arsimi i lartë, atëherë a do të jenë këta profesor apo mësimdhënës, do si quhen si profesor të rregullt, profesor të asocuar, apo profesor asistent respektivisht edhe asistent. Si dhe duhet të përcaktohen kriteret të cilat duhet plotësuar një person që do të fitojë një titull të këtillë, në këtë akademi. Po ashtu, duhet të përcaktohet në këtë ligj, se: cilët tituj do t'i fitojnë kandidatët që do të vijojnë trajnimet, respektivisht arsimin e lartë në kuadër të kësaj akademie. Kështu p.sh. a do të fitohet titulli i oficerit të policit të diplomuar, pastaj specialistit të kriminalistikës dhe sigurisë, pastaj masterit të shkencave kriminalistike dhe sigurisë, dhe eventualisht doktorët e shkencave dhe të kriminalistikës dhe të sigurisë. Po ashtu, me këtë ligj mendoj se, mirë është të precizohet periodha kohore, se kur mund të fillohet zbatimi i këtij arsimit të lartë dhe faza të caktuara të tij?

Më tutje do të isha ndalur dhe do të kisha bërë një krahasim të neni 2 dhe neni 6 dhe nenin 5 më falni.

Në nenin 2, thuhet se: Akademia është institucion përgjegjës, për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, kurse në nenin 5, thuhet se: Akademia është agjenci ekzekutive. Prandaj, mirë është me ligj të precizohet, se a është agjenci ekzekutive, apo është institucion i trajnimeve dhe i arsimit të lartë.

Më tutje do të ndalem në nenin 15.4. ku thuhet: Ku rregullohet përgatitja e planeve për trajnime, më konkretisht thuhet, citoj: “Se detajet dhe procedurat tjera për zbatimin e këtij neni rregullohen me akt ligjor të propozuara nga drejtori dhe të miratuar nga Qeveria”. Unë mendoj se, një akt i tillë nuk ka nevojë të aprovohet nga ana e Qeverisë, mirë është që eventualisht ministria e Punëve të Brendshme të aprovojë plane të trajnimeve, por nuk besoj që është aq e rëndësishme sa të diskutoj për çështjet e tilla dhe vetë Qeveria. Ndërsa, në nenin 17, i cili titullohet bordi i Akademisë, në alinenë 1, të këtij neni flitet për bordin e Kosovës për siguri publike. Prandaj, nuk është e qartë se a kemi të bëjmë me bordin e akademisë apo me bordin e Kosovës për siguri publike dhe mendoj që në këtë projektligj mirë është të precizohet, se cilat janë kompetencat e këtij bordi, pastaj të precizohet se, kush mund të jetë anëtar i këtij bordi, si dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me

procedurat e emërimit, shkarkimit, mandatit dhe çështjet tjera lidhur me vetë funksionimin e këtij bordi. Faleminderit, për vëmendje.

KRYESUESI: Deputeti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Të nderuar anëtarët të Kabinetit,

Kolegë deputetë,

Ky projektligj është një farë mënyre, një dokument i pritur për këtë institucion kaq të rëndësishëm. Është mirë që e kemi tash me kohë, ky institucion siç prezantoj edhe vetë ministri ka funksionuar me disa udhëzime administrative, por ajo çka është më e rëndësishme në institucion që kryesisht ka vepruar me menaxhimin ose nga menaxhimi i agjensioneve ndërkombëtare, e kohëve të fundit është plotësisht i pavarur dhe në hartimin e politikave edukuese për disa agjencione i bënë vetë. Dhe, përfundimisht është mirë që tani ka ligj.

Ato që u thanë këtu, kryesisht mendoj që do të ndikojnë pozitivisht në komisionet përkatëse me e bo plotësime të nevojshme, po ajo çka mendoj që është esenciale tash, ligji nuk i përkufizon ndoshta gjitha ambiciet që i ka ky institucion për të ecë më tej, kryesisht e pasqyron një gjendje aktuale dhe synon futjen e edukimit të lartë dhe kjo është një anë shumë pozitive e ligjit.

Ajo çka tash i mungon mendoj që komisionet dhe mendoj që vetë ministria duhet të insistojë ta fusë, është një karakter regional që duhet ta ketë kjo akademi edhe shumë agjencione që e kanë ndihmuar këtë qendër, kanë pas ide të tilla, sepse kushtet specifike që ofron ky institucion në vendin tonë nuk i kanë disa shtete, do të ishte mirë që në një prej neneve, ndoshta në nenin 2, të futej edhe mundësia që ky institucion të ofrojë shërbimet e veta edhe për institucionet ose kategoritë të njëjta nga vendet fqinje në bashkëpunim me ta. Mendoj që kjo veç po ndodhë, siç e dini në këtë qendër, në këtë akademi ka disa trajnime që bëhen ose janë bërë tashmë edhe për polici ose agjencione të vendeve fqinje, si nga: Shqipëria, Maqedonia etj., pse kjo të mos përkufizohet me ligj?

Krejt në fund, meqenëse ky ligj pasqyron gjendjen aktuale, ajo që duhet po ashtu, me urgjencë të specifikohet është roli i bordit, ky neni që është për bordin me të vërtetë është tash keq, pika 2, lexoni edhe vetë, duhet patjetër të korrigjohet, ajo që duhet të bëhet është, bordit t'i jepen kompetencat tash për ta trajtuar procesin edukativ mësimor tash, ose për ta përkufizuar më qartë rolin derisa të fillojë procesi i edukimit të lartë në përputhje me Ligjin për arsim të lartë të Kosovës, do të nënkuptojë edhe relacione tjera shtesë me Ministrinë e Arsimit të këtij agjensioni apo të këtij institucioni përkatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

I fundit, Burim Ramadani.

BURIM RAMDANI: Faleminderit, kryesues!

Duke ditë faktin se, gjatë tërë këtyre viteve kanë ekzistuar gjithmonë dy lloj tendencave, ose dy lloj rryma sa i përket qasjes për qendrën ose akademinë atje. E para që ka pas të bëjë me ngritjen kësaj qendre në institucion të arsimit të lartë ose sa i përket studimeve të sigurisë publike dhe qasja tjetër që ka qenë mbajtja e një lloj akademie policore ose një qendër trajnuese ose në atë nivel specifik, ky ligj tash duke tentuar që të jetë sa më shumë gjithëpërfshirës, ka dalë të jetë as “mish as peshk” do të thotë, ka dalë të jetë as akademi policore ose qendër trajnuese dhe as institucion i arsimit të lartë në sferën e studimeve të sigurisë publike.

Është tepër me rëndësi që të ketë precizim sa më të saktë dhe bindja ime është se definitivisht duhet të shkohet kah ndërtimi i një institucioni i një arsimit të lartë, për studimet e sigurisë publike në këto fusha që janë, por edhe në fushat tjera që mund të përfshihen në kuadër të kësaj lëmie dhe ajo që dua të them është se, edhe në memorandumin shpjegues që e ka bërë Ministria e Punëve të Brendshme, realisht nuk janë të pranueshme formulimet si në të ardhmen e afërt dhe elementet e tjera që janë të përfshira në memorandum. Pra, duhet të ketë qartësi se kah po shkon drejtimi i qendrës ose i akademisë dhe çfarë do të ndodhë në vitet e ardhshme dhe pa dashtë me i përsëritë edhe ato që mos të mbeten gjitha elementet e tjera tash në varësi të akteve nënligjore që duhet të nxjerrë ministria.

Sa i përket personelit trajnues dhe mësimdhënës, definitivisht duhet të ndahen që personeli trajnues që mund të jenë profesionist të detyrës të angazhuar në institucionet ose agjencitë e tashme të sigurisë dhe personeli mësimdhënës që duhet të jetë, personel që ka gradë shkencore dhe akademike, pra, nuk mund të jenë profesionist të detyrës në aspektin e trajnimit.

Element tjetër që është interesant të thuhet, është neni 13, pika 1.7. ku bëhet fjalë për, kontrollimin e cilësisë dhe e tëra kjo mbetet brenda qendrës ose brenda akademisë dhe definitivisht, kontrollimin e cilësisë duhet ta bëjnë institucionet tjera që janë përgjegjëse për këtë. Sa i përket bordit, duhet precizohet sa anëtarë dhe çfarë niveli të bordit duhet të ketë akademia dhe nuk mund të thuhet se vetëm do të ketë përfaqësues të institucioneve ose agjencive tjera të mekanizmave dhe zbatimit të ligjit sepse kjo lejon hapësirë për ta rritur ose për ta zvogëluar nivelin e përfaqësimit edhe nuk ka garanc të një qasje ma të mirë dhe ma pozitive sa i përket qendrës.

E tha edhe dikush këtu, mu duk ministri Pajaziti, se roli kësaj ose qëllimi i kësaj Qeverie duhet të jetë që kjo qendër ose kjo akademi të ketë rol rajonal në trajnime dhe në mësimdhënie të studimeve të sigurisë publike dhe ky realisht ka qenë me qëllim, prej 2007 e këndeje, asnjëherë nuk është realizua, tash definitivisht me këtë ligj duhet t'i japim këtë drejtim, përndryshe nuk besoj që ia vlen që të kemi këtë lloj gjithë përfshirje dhe të mos kemi assesë qasjen se çfarë roli duhet t'i japim kësaj akademie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur.

Zoti ministër, a dëshironi fjalën? Fjalën e ka ministri Rexhepi.

BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Duke falënderuar për sugjerimet dhe kontributin në leximin e parë, desha t'i bëj disa sqarime.

Realisht, ky ligj i ardhshëm e definon statusin e kësaj akademie, e cila ka qenë e rregulluar me Rregullore të UNMIK-ut dhe se ka pas shumë të qartë, pra është një agjension në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

U përmend edhe çështja, çfarë shërbime jep kjo akademi e ardhshme, për momentin janë trajnimet bazike dhe të specializuara, për kategoritë që u përmend ma herët mos t'i përsëris sërish, me mundësi që edhe ndonjë agjencion tjetër nëse ka nevojë për trajnime specifike të bëhen në këtë akademi dhe e krijon bazën ligjore për akreditim të ardhshëm të një akademie, për siguri publike që i mungon, por kjo, t'ju them shumë sinqerisht, këtu është ai fleksibiliteti, se ka dy koncepte që i përmendi edhe Burimi dhe është dashur me i harmonizuar dhe tash nuk mundeni t'i precizoni gjitha me ligj dhe pas 2-3 vjetëve, prapë me ju nënshtruar ndryshimeve. Po e krijon bazën për akreditim, për një akademi për siguri publike të nivelit bachelor.

Sa i përket doktoraturë e tjera, ato do të mbesin edhe më tutje në nivel të Universitetit të Prishtinës, kështu që nuk janë ambicie të kësaj akademie që del edhe mbi Universitet të Prishtinës dhe natyrisht që duhet të harmonizohen edhe për çështje mësimdhënëseve, çështjen e bordit shumë gjëra që mbesin për të ardhmen.

U përmend edhe çështja e përzgjedhjes së drejtorit ekzekutiv të kësaj qendre, nuk ka nevojë të precizohet me ligj, në mënyrë që për arsye se edhe krye shefi ekzekutiv i nënshtrohet çështjes së konkursit që rregullohet nga Ministria e Administratës Publike, pra niveli i sekretarëve të përgjithshëm dhe krye shfave ekzekutiv, procedura është shumë e rregulluar dhe në të ardhmen do të jetë shërbyes civilë nuk do të thuhet se është i policisë ose diçka tjetër, prandaj nuk ka nevojë të precizohet, me ligj kjo se është e rregulluar.

Një shqetësim ke, çështja e pagesave, natyrisht që për një qëndrueshmëri financiare kjo u jep shërbime p.sh. për poligonin e tipit të mbyllur për qitje që natyrisht nëse jep këto shërbime vinë edhe ata duhet të paguajnë, mund të ketë po ashtu edhe kompanitë e Sigurimit Fizik që kërkojnë që të licencohen dhe të kenë shërbime të posaçme nga kjo qendër natyrisht që edhe ata duhet të paguajnë, prandaj këto janë ato çështjet që përmendet pagesa dhe këtu u kërkuar në një mënyrë që edhe brenda organo gramit çdo detal precizohet me ligj, kjo nuk ka nevojë të bëhet, por bëhet me urdhëresa administrative dhe aktet tjera nënligjore, mendoj se edhe ashtu është koncepti i ligjit dhe ashtu duhet të vazhdohet.

Ndërsa, sa i përket karakterit regjional edhe sot e ka këtë karakter regjional, shpeshherë për shërbimet zjarrfikësve ose kategorive tjera organizohen trajnimet e posaçme dhe sa do të jemi na karakter regjional, do të varet nga cilësia që na ofrojnë, për momentin na duhet me i forcua, nuk e kemi nivelin ma të mirë edhe trajnimet bazike dhe të specializuara do të vazhdojnë me këto shërbime dhe në një afat kohorë që unë mendoj, se

brenda 4-5 vjetëve do të bëjmë përgatitje për nivelin bachelor për siguri publike, për momentin këtë nuk mundemi ta bëjmë dhe këtu është ajo fleksibiliteti i ligjit dhe qëllimisht ka qenë që mos të kemi nevojë pas 2-3 vjetëve ta ndërrojmë këtë bazë ligjore. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!

Të lajmëruar nuk ka, në sallë janë 90 deputetë, hymë në procedurën e votimit, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash: Konstatoj se, me 64 vota “për”, 22 “kundër”, “1” abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Kërkohej nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime dhe konsideroj që është ardhur koha për një pauzë. Seanca fillon në ora 15:00.

(pjesa e dytë)

KRYESUESI: Të nderuar, deputetë!
Mund të ia fillojmë seancës,

Pika vijuese është: Shqyrtimi i parë i projektligjit “qendrën historike të Prizrenit”.

Në bazë të nenit 56, të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj ministrin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi. Që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

DARDAN GASHI: I nderuar, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Për këtë projektligj është diskutuar shumë edhe në publik, unë sot nuk e kam ndërmend të zgjati shumë, vetëm t’i cekim disa pika të rëndësishme sa i përket këtij projektligji.

1. Ky ligj është pjesë e pakos së Ahtisarit dhe na obligon, si Qeveri dhe si Parlament dhe si shtet që ta draftojmë dhe ta përkrahim këtë ligj, si pikë e
2. Ky ligj është pjesë e Raportit të Progresit të komisionit evropianë, si pikë e rëndësishme e Progresit, Raportit Progresit
3. Ky ligj është në përputhshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,
4. Ky ligj ndikon drejtpërdrejtë në marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me miqtë dhe aleatët e Republikës së Kosovës dhe si i tillë, ju kisha lut dhe ju lus dhe apeloj që ky ligj të miratohet në ashtu siç është propozuar.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër për racionalizimin e kohës.
Fjalën e ka, kryetari i komisionit, deputeti Nait Hasani!

NAIT HASANI: Përshëndetje, kryetar!

Përshëndetje kolegë,

Deputetë,

Komisioni për Bujqësi dhe Planifikim Hapësinor, në mbledhjen e djeshme ka shqyrtuar Projektligjin për qendrën historike të Prizrenit dhe ka kërkuar, ka dhënë rekomandim që të mos miratohet në parim Projektligji për qendrën historike të Prizrenit dhe t'i kthehet Qeverisë për ripunim.

Në mbledhjen e djeshme kemi pasur reagime të shumta nga organizatat joqeveritare, nga asociacionet e ndryshme, të cilët kanë ardhur te ne nga Bashkësia Islame, kanë kërkuar që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë për ripunim, t'i kthehet Qeverisë dhe që ta bëjë një debat publik që pikërisht atje të diskutohet çështja, sepse ka dhe çështje që janë të pazgjidhura, sidomos për çështje të kishave, xhamive, kishave katolike etj.

Monumentet historike që i trajton ky ligj dhe ky projektligj, si vlera të trashëgimisë kulturore, janë monumentet të cilat nuk kanë të bëjnë edhe me trashëgiminë kulturore, siç është konsullata ruse në Prizren, siç është shkolla e priftave po ashtu në Prizren, prandaj, edhe të tjera ka që nuk mund të numërohen, por kërkojmë që edhe kem kërkuar që në, me një votim unanim në komision, ia kemi kthyer Kuvendit që seanca t'ia kthej Qeverisë, ta bëjë një debat publik dhe t'i trajtojë më mirë këto çështje, sepse vlerat historike të kulturës nuk mund të jenë vetëm të një bashkësie, të kulturës ose të një bashkësie p.sh. të kishës ortodokse serbe. Xhamitë janë ndreq diku para 400-500 vjetëve, ndërsa kishat thuhet se janë diku 500-600 vjetëve po ashtu, por para kësaj kohe, të kujt kanë qenë ato kisha, e kujt ka qenë ajo kulturë, nëse këto kanë qenë vetëm të komunitetit serb që thuhet janë ndërtuar atëherë ne e dimë që kombet janë krijuar para 100 vjetëve. Prandaj, gjitha këto i ka pasur parasysh komisioni dhe ka kërkuar që Kuvendit ta kthejë Qeverisë, sepse nëse thirremi në Raportin e Progresit, pak më herët kërkuam dy ligje të Raportit të Progresit, çështjen e banesave, Ligjin për mbeturina dhe Ligjin për, që e pat deputeti... na i kthyer që nuk ka mundësi të hyjnë si rend të ditës, prandaj, kërkojmë që kjo nuk është më çështje e Raportit të progresit, por është çështje etnitetit, çështje e kulturës, çështje e traditës. Me këtë ligj nëse e miratojmë në këtë formë kështu, shqiptarët në Prizren mbesin pa kulturë, pa traditë, pa asgjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Tani e kanë radhën, kryetarët e grupeve parlamentare.

Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: I nderuari kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në debatin e djeshëm që e pati Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, vërtetë ka qenë një debat me emocione, ku ky problem u trajtua ashtu siç u trajtua dhe ishte një vendim unanim që ky projektligj të kthehet në Qeveri. Në fakt, këtij debati i paraprinë një situatë jo e qartë, d.m.th. kishim emocione, sikurse përherë që ka emocione ky lloj debati. Ne gjithë nuk ishim dakord që ky

projektligj të kalojë, për shkak se ky projektligj nuk është edhe i tillë që mund të kthehet prapa, nuk ka diçka që është kontestuese. Ju vetë e dini që ne paraprakisht, e kemi aprovuar një ligj më përpara dhe ky është derivat i vet atij ligji të mëparshëm, i Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtjes.

Atëherë, kur është aprovuar ky ligj dhe ky ligj ka qenë një lloj instrumenti për ta bijetësuar Pavarësinë e Kosovës, nuk ka qenë pengesë e madhe, ndërsa tash përnjëherë u bë që të dal një ligj i tillë dhe të jetë pengesë. Nuk është në rregull që ne tash të merremi me problemin e emërimit, ta marrim kisha katolike serbe të jetë pengesë për t'u kaluar ky ligj, së paku, për... në parim, në shqyrtim, në radhën e dytë ne ta kemi të plotësuar dhe të ndryshuar atje ku neve na merr mendja, ku të arrijmë ta bëjmë një debat të përbashkët gjithë.

Kosova ka nevojë për ligje tilla, me të cilat kjo do t'i mbrojë vlerat kulturore dhe historike, të cilat janë krijuar nga brezat nëpër shekuj. Ky projekt do të promovojë vlerat e qytetarëve të Prizrenit, të cilat nuk janë vetëm vlerat që me karakter kombëtar, por edhe botëror. Për shkak të diversitetit kulturor tyre, janë interes i madh për kulturën dhe civilizimin e këtij lokaliteti.